



Qasja gjithpërfshirëse dhe multi-sektoriale ndaj Dhunës në Familje

Autore: Ardiana Gashi

Tirazhi: 100

Ky raport është përkrahur nga UN Women në kuadër të Programit të Përbashkët të Ekipit të Agjensioneve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe mendimet e shprehura këtu nuk reflektojnë ato të UN Women



Studimi bazë : Alokimi i buxhetit për shërbimet e Dhunës në Familje në nivel komunal; funksionaliteti i mekanizmave koordinues dhe njohuri mbi Buxhetimin e Përgjithshëm Gjinnor ne 3 pilot komunat (Gjakovë, Gjilan, Dragash) /Shtator 2012

Fjalori i termave	5
1. Hyrje	7
2. Metodologjia	8
3. Ligjet dhe strategjitë me rëndësi për BGJ dhe dhunën në familje në Kosovë	9
4. Përshkrimi i rrugës nëpër të cilën kalojnë të mbijetuarit e dhunës në familje në Kosovë ..	14
4.1 Shtëpitë strehuese	15
5. Proceset e planifikimit buxhetor	19
5.1 Përshkrimi i buxhetit dhe procedurat për përgatitjen e buxhetit komunal	19
5.2 Procedurat e buxhetit komunal: si janë përcaktuar prioritetet dhe si janë bërë alokimet: gjetjet nga intervistat	25
6. Alokimet financiare në nivel lokal për përgjigje ndaj Dhunës në Familje: gjetjet nga intervistat.....	26
7. Procesi me pjesëmarrje në lidhje me përgatitjen e buxhetit në nivel komunal: gjetjet nga intervistat.....	27
8. Burimet njerëzore aktive në përgjigje ndaj DhF në komuna: zyrtarja për barazi gjinore....	29
9. Funksionimi i mekanizmit koordinues dhe niveli i njohjes së ofruesve të shërbimeve mbi DhF dhe BPGJ: gjetjet nga sondazhi me anëtarët e mekanizmi koordinues	31
10. Zhvillimet aktuale lidhur me DhF: RrGK; OSBE dhe UNDP.....	37
11. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet	38
Referencat	41
Shtojcë: Pyetësi.....	42
Pyetësi.....	43

Fjalori i termave

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (parti politike)		Përgjegjësitë
LKD	Ligji Kundër Diskriminimit	MF	Ministria e Financave
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore	DKSHMS	Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
AKR	Aleanca Kosova e Re (parti politike)	MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave	MoU	Memorandumi I Mirëkuptimit
QPS	Qendrat për Punë Sociale	OJQ	Organizatë Joqeveritare
DFID	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar	OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
DhF	Dhuna në familje	PDK	Partia Demokratike e Kosovës
BGJ	Barazi Gjinore	QMRGF-P	Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve në Prizren
BPGJ	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor	UNDP	Programi për Zhvillim I Kombeve të Bashkuara
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit	UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracion	UNSCR 1325	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325
BAK	Buxheti Afatmesëm Komunal	UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave
PKBGJ	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore		
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës		
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës		
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe		

1.

Hyrje

Dhuna në familje (DhF) mbetet një nga sfidat me të cilat përballen autoritetet e Kosovës. Progres është shënuar posaçërisht sa i përket zhvillimit të një kornize ligjore dhe dokumenteve strategjike me qëllim të parandalimit të dhunës në familje dhe ofrimit të shërbimeve për të mbijetuarat e Dhunës në Familje. Megjithatë, ka shumë sfida që lidhen kryesisht me ri-integrimin e të mbijetuarve të DhF për shkak të kufizimeve fiskale me të cilat ballafaqohet Qeveria e Kosovës dhe një numri të madh të përparësive që ka Kosova si një shtet i ri. Ajo që është e qartë është se, raportimi i DhF është rritur i cili megjithatë nuk do të thotë se DhF është rritur. Për më tepër në krahasim me burrat, është zbuluar se gratë janë më të prirura për të qenë subjekt i dhunës në familje.

Gjatë vitit 2011 Qendrat për Punë Sociale në Kosovë raportuan për 226 raste të dhunës në familje nga të cilat 132 ishin gra dhe 94 ishin fëmijë. Bazuar në monitorimin e bërë në të gjitha shtëpitë strehuese të OJQ-ve/ gjatë vitit 2011 ka pasur 204 gra të mbijetuara të dhunës në familje dhe 187 fëmijë të strehuar me nënat e tyre në shtëpitë strehuese. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2012 janë ofruar shërbime

sociale nga Qendrat për Punë Sociale në Kosovë për 105 gra dhe 38 fëmijë të këtyre nënave.

Pavarësisht zhvillimeve në fushën e DhF, kjo fushë ka nevojë për përmirësim si në parandalimin e dhunës në familje, por gjithashtu edhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për të mbijetuarit e DhF për të cilat është e ngarkuar një gamë e gjerë e institucioneve¹. Në përputhje me këto qëllimi i këtij projekti është i trefishtë:

- a) Qëllimi i parë është të kuptohet nëse komunat e Dragashit, Gjakovës dhe Gjilanit kanë një linjë buxhetore për DhF dhe të kuptohet se si është bërë buxhetimi dhe nga cila linjë buxhetore është ofruar mbështetja, nëse është ofruar. Kjo është bërë në mënyrë që të identifikohet një linjë të mundshme buxhetore që mund të përdoret për të alokuar fonde për DhF;
- b) Qëllimi i dytë është që të kuptohet funksionimi i mekanizmit koordinues (një mekanizëm që përfshin përfaqësues nga të gjitha institucionet që janë të angazhuara në ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarit e DhF) dhe nevojat e tyre të zhvillimit, sa i përket ofrimit të shërbimeve të mjaftueshme për të mbijetuarit e DhF

¹ Shih Kapitullin 4.

- c) Qëllimi i tretë është për të marrë informacion mbi njohuritë që anëtarët e mekanizmit koordinues kanë për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe nëse institucionet e tyre e aplikojnë këtë procedurë të buxhetimit.

Pas mbledhjes së informacionit do të përpilohen propozimet për të informuar mbi mënyrën më të mirë për të promovuar alokimin e buxhetit në nivel lokal për DhF dhe mbi nevojat e zhvillimit të kapaciteteve për mekanizmin koordinues që do të mbështesë ofrimin e shërbimeve më cilësore. Më në fund duke u bazuar në nivelin e tyre të njohurive mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, do të ofrohet informacion mbi nevojat e trajnimit. Përshkrimi i metodologjisë së paraqitur në seksionin në vijim thekson qasjen e gjerë të përdorur në këtë raport duke përfshirë një gamë të gjerë të akterëve.

2. Metodologjia

Për të arritur synimet e lartpërmendura të raportit është aplikuar metodologjia e mëposhtme. Metodologjia e përdorur për të përmbushur objektivat e këtij misioni kërkimor ishte një kombinim i rishikimit dhe hulumtimit të punës dhe kompletimi i punës në terren dhe intervistave të komunitetit. Pika e nisjes ishte që të kuptohet korniza ligjore e cila

mbështet mbrojtjen kundër dhunës në familje dhe mbështetjen për të mbijetuarit e dhunës në familje. Për të kuptuar nëse Kosova raporton mbi dokumentet ndërkombëtare për barazinë gjinore, dmth CEDAW dhe UNSCR 1325 është zhvilluar një intervistë me Drejtorin Ekzekutiv dhe Zyrtarët e Agjencisë për Barazi Gjinore. Nga intervista me Agjencinë qëllimi ishte edhe për të kuptuar nëse Agjencia është e angazhuar në procesin e buxhetimit për DhF dhe gjithashtu në zhvillimet aktuale në lidhje me DhF.

Me qëllim të marrjes së informacionit mbi proceset e buxhetimit në komuna u zhvillua një intervistë me Ministrinë e Financave. Një intervistë është bërë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale me Drejtorin e Buxhetit dhe Financave dhe Departamentin për Mirëqenie Sociale. Informatat janë mbledhur lidhur me atë se si janë bërë buxhetimet për shërbimet sociale për Qendrat komunale për Punë Sociale.

Drejtorët e Departamentit të Financave në komunën e Dragashit, Gjakovës dhe Gjilanit janë intervistuar për të kuptuar pikat e mëposhtme: procedurat e buxhetimit në nivel komunal; si janë caktuar prioritetet dhe si është përgatitur buxheti në bazë të këtyre prioritetëve; nëse komuna e cakton buxhetin për Aktivitete mbi Dhunën në Familje; nëse dhe se çfarë lloji i shërbimeve janë të mbështetura financiarisht nga komuna dhe nga cila linjë buxhetore; për të kuptuar procesin me pjesëmarrje të qytetarëve mbi përgatitjen e buxhetit. Informacioni më i rëndësishëm që ka për qëllim të mblidhet nga intervista me Drejtorët e

Departamentit të Financave ishte identifikimi i linjës buxhetore që mund të përdoret për të alokuar buxhetin për shërbime për të mbijetuarit e DhF.

Në të gjitha këto komuna ekziston zyrtarja/i për barazi gjinore (BGJ). Zyrtarët/et në tre komuna janë intervistuar për të mbledhur informacion mbi rolin e tyre në aktivitetet lidhur me DhF dhe nëse ata janë të angazhuar në përgatitjen e buxhetit dhe dëgjimeve publike në komuna. Pyetjet janë adresuar në informacionin e tyre për mbështetjen e ofruar financiare për të mbijetuarit e DhF.

Intervistat janë zhvilluar me tre shtëpi strehuese: Gjilan, Gjakovë dhe Prizren (kjo akomodon komunën e Dragashit). Pyetjet drejtuar për shtëpitë strehuese kishin të bënin me kapacitetin e tyre mbrojtës; burimet financiare, aktivitetet në dispozicion për të mbijetuarit e DhF, stafin dhe zhvillimin profesional; statistikën mbi numrin e personave të strehuar në 2011 dhe 2012 dhe informacione tjera të ngjashme.

Një komponent i projektit ishte sondazhi që është bërë duke shpërndarë një numër të pyetësorëve për anëtarët e mekanizmit koordinues, përkatësisht shefit të Departamentit të Arsimit dhe Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; Mbrojtësit të mbijetuarve të DhF; strehimorëve; Zyrtarëve për BGJ; punonjësve të policisë; Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale dhe një gjykatësi - të gjithë këta anëtarë në tre komunat. Qëllimet e sondazhit ishin:

- për të kuptuar nivelin e funksionalizimit dhe rolin e mekanizmave të koordinues për DhF në tre komunat;
- për të kuptuar nivelin e njohurive të të gjithë anëtarëve mbi ligjet dhe dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore
- për të marrë informacione mbi njohuritë e tyre mbi mbështetjen financiare të ofruar nga komunat
- për të kuptuar nivelin e tyre të njohurive mbi buxhetimin gjinor dhe zbatimin e procedurave të tilla buxhetore në institucionet e tyre.

Bazuar në përgjigjet nga sondazhi, do të propozohen propozimet për aktivitetet e mëtejshme.

Për të kuptuar zhvillimet aktuale lidhur me DhF u zhvilluan intervista me Rrjetin e Grave të Kosovës, OSBE dhe UNDP si tre institucionet më aktive në fushën e DhF.

3.

Ligjet dhe Strategjitë për Barazinë Gjinore

dhe dhunën në familje në Kosovë

Në këtë seksion do të bëhet rishikimi i ligjeve, strategjive dhe dokumenteve të tjera të disponueshme në Kosovë, duke u fokusuar në komponentin e dhunës në familje.

Ligji Nr.2004/2 mbi Barazinë Gjinore në Kosovë, thekson barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fushat tjera të jetës sociale. Ligji përcakton institucionet dhe organet drejtuese që janë përgjegjëse për të siguruar barazinë gjinore. Ligji për Barazi Gjinore u miratua në vitin 2004 i cili ka sjellë krijimin e mekanizmave institucionalë për arritjen e barazisë gjinore në nivel kombëtar dhe lokal.

a) Mekanizmat institucional për barazi gjinore në nivel kombëtar:

- Agjencia për Barazi Gjinore / Zyra e Kryeministrit: Qeveria e Kosovës në vitin 2005 ka themeluar Zyrën për Barazi Gjinore pas Ligjit për Barazi Gjinore të vitit 2004. Në shtator të vitit 2006, Zyra u transformua në Agjenci për Barazi Gjinore e themeluar si agjenci ekzekutive përgjegjëse për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, si një përcaktues i rëndësishëm për funksionimin demokratik të institucioneve.

- Zyra këshilluese për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore - e cila këshillon, monitoron dhe zhvillon politikat duke promovuar qeverisjen e mirë, Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Sigurimin e Mundësive të Barabarta dhe Barazinë Gjinore.

- Njësia për Barazi Gjinore - Institucioni i Ombudspersonit

- Zyrtarët për Barazi Gjinore në ministritë dhe

- Këshilli Ndërmintor për Barazi Gjinore

b) Mekanizmat institucional për barazi gjinore në nivel lokal:

- Zyrtarët për barazi gjinore në komuna

- Komitetet komunale për barazi gjinore

Ligji nuk bën ndonjë referencë ndaj dhunës në familje.

Ligji Nr.2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin, kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, marrëdhëniet për pasurinë e familjes dhe procedurat e posaçme gjyqësore për kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare. Në kuadër të ligjit ekzistojnë dy nene të cilat përmendin dhunën: Neni 59 Parimet e Përgjithshme tregon se gjykata dhe çdo person në fjalë me një shkelje në martesës duhet të ketë parasysh parimet e përgjithshme të përmendura ndër të cilat është përfshirë çdo rrezik me dëme ose dhunë ndaj bashkëshortëve dhe ndaj fëmijëve duhet të shmanget. Neni 63-Frika, Dhuna, Kërcënimi thekson se martesa do të anulohet nëse bashkëshorti-ja e ka

dhënë pëlqimin nën frikë, dhunë ose kërcënim serioz.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) 2008-2013, i miratuar në vitin 2008 ka për qëllim të stimulojë dialogun mbi integrimin e barazisë gjinore në Kosovë, që është, pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në jetën sociale, ekonomike, dhe politike të vendit, mundësi të barabarta për burrat dhe gratë të gëzojnë të drejtat dhe për të vënë potencialet e tyre individuale në shërbim dhe në të mirë të shërbimit ". Edhe pse dokumenti i referohet studimeve mbi dhunën në familje që ofrojnë dëshmi se gratë janë kryesisht viktimat të dhunës në familje, Programi Kombëtar nuk vendos asnjë qëllim për të zvogëluar ose adresuar dhunën në familje.

Ligji Nr.03/L -182 Për mbrojtje kundër dhunës në familje është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 1 korrik 2010 i cili shfuqizoi Rregulloren e UNMIK-ut nr 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje. Ligji synon të parandalojë dhunën në familje, në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore, të anëtarëve të familjes, që janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Ligji, gjithashtu ka për qëllim trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave. Ligji përkufizon Dhunën në Familje - si një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bëjnë një person ndaj personit tjetër me të cilin ai ose ajo është ose ka qenë në marrëdhënie familjare. Ligji përcakton masat mbrojtëse për viktimën e DhF,

urdhëra të mbrojtjes dhe përgjegjësitë e policisë.

Ligji Kundër Diskriminimit është miratuar në 2004/3 u miratua në vitin 2004 qëllimi kryesor i të cilit është parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, promovimi i barazisë efektive dhe vënia në zbatim i parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës nën sundimin e ligjit. Parimet e këtij ligji janë: rregullimi i çështjeve që kanë të bëjnë me mosdiskriminimin mbështetet në këto parime: parimi i trajtimit të barabartë që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj asnjë personi apo personave, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, përkatësisë apo bindjeve politike, përkatësisë etnike, kombësisë, religjionit apo besimit, racës, prejardhjes sociale, pasurisë, lindjes ose statuseve tjera; b) Parimi i përfaqësimit të drejtë të të gjithë personave dhe të të gjithë anëtarëve të komuniteteve lidhur me punësim në kuadër të organeve publike në të gjitha nivelet, dhe c) Parimi i mirëkuptimit të mirë dhe tolerancës ndëretnike të qytetarëve të Kosovës.

Një dokument i rëndësishëm në lidhje me DhF është **Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014**, një dokument që ka për qëllim "ndërtimin e një ambienti shoqëror, ekonomik dhe ligjor, i cili siguron që anëtarët e familjes (gratë dhe vajzat) të jetojnë në një shoqëri pa dhunë, e cila ofron hapësirë për t'u përfshirë në lëvizjet aktive për

ndryshimin e jetës së tyre ". Ky qëllim ka tendencë të arrihet përmes tri objektiva kryesore:

- Të krijojë mekanizma efektiv për parandalimin, mbrojtjen, trajtimin, rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të dhunës.
- Të gjejë më shumë mënyra për të fuqizuar dhe përfshirë në jetën normale çdo individ të marginalizuar dhe të përjashtuar për shkak të dhunës në familje.
- Për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë sonë për dhunën në familje si një nga shkaqet e problemeve sociale dhe ekonomike.

Tre objektivat kryesore strategjike të planit të veprimit 2011-2014 janë:

1. deri në vitin 2014, të krijohen mekanizma efikas dhe gjithëpërfshirës për parandalimin e dhunës në familje;
2. të menaxhohet deri në vitin 2013, të pasurit e mekanizmave efikas të mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje;
3. dhe të sigurohen shërbime efikase për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave dhe kryerësve të dhunës në familje në të gjithë territorin e Kosovës.

Një nga aktivitetet që lidhen me objektivin e dytë është 'nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit në mes të institucioneve të përfshira në trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Strategjia dhe Plani i Veprimit liston institucionet që trajtojnë dhunën në familje ndër të cilat MPMS është një

institucion i rëndësishëm e cila përmes Qendrave për Punë Sociale duhet të sigurojë mbrojtje sociale për viktimat, duke përfshirë asistencë, këshillim dhe ndihmë materiale, kur burimet e financimit janë në dispozicion. Për më tepër, QPS-të si autoritete për sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve në nevojë kanë një përgjegjësi ligjore për të përfaqësuar interesat më të mirë të fëmijës në procedurat gjyqësore. Në rastet civile, QPS-të japin mendimet e tyre në lidhje me kujdestarinë e fëmijës. Në mënyrë indirekte, QPS-të gjithashtu mund të ndikojnë në qasjen në drejtësi. Ofrimi i asistencës sociale apo mbështetjes së QPS-së mbi kujdestarinë e fëmijës mund të bëjë ndryshime për gratë që kërkojnë largim nga lidhjet e dhunshme familjare dhe kujdestarinë e sigurt të fëmijëve të tyre. Nuk ekziston asnjë agjenci qeveritare që drejtëpërdrejtë ofron shërbime për viktimat e dhunës në familje; megjithatë MPMS ofron mbështetje financiare për OJQ-të që menaxhojnë strehimoret për viktimat e dhunës në familje, ku gjithashtu janë të vendosura disa viktima të trafikimit. Megjithatë dokumenti nuk tregon një rol që MPMS duhet të luajë në procesin e re-integrimit përmes mbështetjes së arsimit dhe punësimit për të mbijetuarit e dhunës në familje. Ri-integrimi mbetet një nga sfidat kryesore në lidhje me mbështetjen e dhënë për të mbijetuarit e DhF i cili është treguar edhe nga Rames (2012) duke deklaruar se një nga boshllëqet më të shënuara është mungesa e shërbimeve riintegruese për viktimat e dhunës. Qendrat për Punë Sociale dhe Zyrat Rajonale të Punësimit ofrojnë shumë pak mbështetje për riintegrim. Si rezultat i kësaj, OJQ-të (në

strehimore të veçanta), është dashur që në masë të madhe të marrin gjërat në duart e tyre. Megjithatë, për shkak të mungesës së fondeve, strehimoret kanë arritur të gjejnë një numër të kufizuar të vendeve të punës për të mbijetuarit e DhF. Përfundimi I arritur është se ka shumë pak mbështetje në nivel qendror dhe lokal për riintegrim.

Implementimi i dokumenteve ndërkombëtare për barazi gjinore në Kosovë

Edhe pse Kosova nuk është një vend nënshkrues, ekzistojnë dy dokumente të rëndësishme të cilat pasqyrohen në Ligje dhe rregulloret dhe strategjitë tjera në lidhje me gjininë - Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325. Këto dy dokumente shërbyen si udhëzues për zhvillimin e kornizës ligjore për barazi gjinore në Kosovë.

Implementimi i CEDAW në Kosovë

Neni 2 i CEDAW tregon se Shtetet palë dënojnë diskriminimin e gruas në të gjitha format e tij, pranon të ndjekë me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë një politikë për eliminimin e diskriminimit ndaj grave dhe, për këtë qëllim, merr përsipër: (a) Të realizojë parimin e barazisë së burrave dhe grave në kushtetutat e tyre kombëtare ose në legjislacionin tjetër përkatës, nëse nuk janë të përfshirë dhe të sigurojë, me anë të ligjit dhe mjeteve tjera të përshtatshme, realizimin praktik të këtij parimi; (b) Të miratojë masat legjislative dhe masa të tjera, duke përfshirë sanksione kur është e

përshtatshme, të cilat ndalojnë çdo diskriminim ndaj grave; (c) Të vendosë mbrojtje gjyqësore të të drejtave të grave mbi baza të barabarta me burrat dhe të garantojë, përmes gjykatave kombëtare kompetente dhe institucioneve të tjera publike, mbrojtjen efektive të grave kundër çdo akti të diskriminimit; (d) Të mos marrë pjesë në asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj grave dhe të sigurojë që autoritetet publike dhe institucionet duhet të veprojnë në përputhje me këtë detyrim; (e) T'i ndërmerr të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave nga çdo person, organizatë ose ndërmarrje; (f) T'i ndërmerr të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin, për të modifikuar ose shfuqizuar ligjet ekzistuese, rregulloret, zakonet dhe praktikatat që përmbajnë diskriminim ndaj gruas; (g) Të shfuqizoj të gjitha dispozitat penale që përmbajnë diskriminim ndaj gruas.

Siç tregohet në intervistën me zyrtarët e ABGJ të zhvilluar në korrik të vitit 2012, Kosova nuk ka raportuar mbi CEDAW. Qendra për Studime Gjinore e Kosovës (2008) ka realizuar një hulumtim mbi monitorimin e implementimit të CEDAW në Kosovë, i cili tregon gjetjet e përshkruara më poshtë: niveli i vetëdijësimit të grave për të drejtat e tyre ligjore është i ulët (Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 2008). Institucioni i Ombudspersonit thekson se vetëdijësimi i shoqërisë kosovare në lidhje me parimin e diskriminimit dhe luftës kundër diskriminimit është i ulët. Të gjitha raportet tregojnë se grupet si

grate janë të marginalizuara, gjë që konfirmon praninë e praktikave diskriminuese në të gjitha sferat e jetës publike. Edhe pse ligji u jep të drejta grave mbi pronë, qira dhe trashëgimi të pronës, e drejta e zakonit nuk e siguron këtë, e cila e drejtë është ende në përdorim në Kosovë. Shumë gra nuk pretendojnë të drejtën e tyre, që e bën më të vështirë perspektivën e tyre ekonomike (Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 2007).

Implementimi i Rezolutës të Këshillit të Sigurimit (SCR) 1325 "Gratë, paqja dhe siguria" në Kosovë

Neni 24 i Kushtetutës së Kosovës përcakton se mbrojtja e barabartë ligjore nuk parandalon caktimin e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Më tej, Ligji Kundër Diskriminimit (LKD) ndalon diskriminimin në të gjitha sferat e jetës shoqërore: arsim, përkujdesje sociale, punësim, strehim, siguri personale, dhe qasje në jetën publike. Qeveria është përgjegjëse për ngritjen e vetëdijes për LKD, dhe Institucioni i Ombudspersonit është i autorizuar për pranimin dhe hetimin e ankesave në lidhje me diskriminimin. Trajnimet janë ofruar për gjyqtarët, prokurorët dhe nëpunësit civil mbi përdorimin praktik të Ligjit.

Deri tani nuk ekziston ndonjë studim për implementimin e SCR 1325 në Kosovë. Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore, në shkurt të vitit 2012 ka vendosur të themelojë grupin punues

për zhvillimin e Planit të Veprimit për implementimin e UNSCR 1325.

4. Përshkrimi i rrugës nëpër të cilën kalojnë të mbijetuarat e dhunës në familje në Kosovë

Rruga nëpër të cilën kalojnë të mbijetuarit e dhunës në familje në Kosovë është si në vijim:

1. **I/e mbijetuara e DhF** njofton policinë. Njësia për dhunën në familje shkon tek i mbijetuari në vendin nga ku DhF raportohet menjëherë pasi që rasti është paraqitur në polici. Policia bisedon me të mbijetuarin e DhF dhe kryerësit e dhunës në familje. Në rastet kur shenjat e dhunës fizike janë të dukshme i mbijetuari i DhF kryen një kontroll mjekësor. I mbijetuari i DhF informohet për shërbimet që ai / ajo mund të përdorë; strehimorja ku ajo mund të vendoset, mbrojtja me ndihmë ligjore të cilën ai/ajo mund të

marrë nga mbrojtësit nga DhF dhe të gjitha shërbimet e tjera.

2. **Nëse i/e mbijetuara e DhF kërkon**, policia e hapë çështjen e cila dërgohet në prokurori. Policia e raporton rastin edhe në polici rajonale dhe në njësinë për DhF në qendër në Prishtinë. I/e mbijetuara e DhF (së bashku me fëmijët) dërgohet në polici, ku merret deklarata dhe ku e mbijetuara informohet për hapat në vijim.
3. **Policia** gjithashtu e informon mbrojtësin e viktimës, i cili është një person që e shoqëron viktimën në të gjitha hapat e procesit deri në akomodimin e përkohshëm të viktimës tek familja e saj apo në një shtëpi strehuese.
4. **Policia gjithashtu** njofton qendrën për punë sociale (QPS) dhe kjo në rastet kur e mbijetuara e DhF ka fëmijë përndryshe nuk është e detyruar të informojë QPS.
5. **Prokuroria** kontrollon faktet dhe raportin e dëshmitarit dhe merr vendim për të hapur apo jo një rast gjyqësor. Nëse ka fakte të mjaftueshme dhe viktimë dëshiron të vazhdojë çështjen në gjykatë, prokuroria dërgon çështjen në gjykatë, përndryshe rasti nuk vazhdohet më tej.
6. E mbijetuara e DhF (nëse ka nevojë), dërgohet në **institucionin e sigurt-shtëpinë strehuese**, ku ajo mund të qëndrojë për maksimum 6 muaj, ku të mbijetuarat e DhF veç strehimit marrin programe të

ndryshme në lidhje me arsim, punësim dhe riintegrim në shoqëri.

Duke pranuar rolin që luajnë shtëpitë strehuese në sigurimin e një vendi të sigurt, udhëzimet dhe zhvillimin e të mbijetuarve të DhF, janë intervistuar tre strehimoret që mbulojnë tre komunat e zgjedhura për këtë hulumtim dhe gjetjet janë të paraqitura në nën-seksionin në vijim.

4.1 Shtëpitë strehuese

Intervista gjysmë të strukturuar janë realizuar me shtëpitë strehuese në Gjilan, Gjakovë dhe Prizren. Gjetjet dhe rezultatet janë:

Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve -QMRGF-P në **Prizren** është themeluar në vitin 2002. Strehimorja është pjesë e mekanizmit koordinues për DhF për rajonin e Prizrenit e cila edhe pse mbulon komunën e Dragashit, nuk ka asnjë përfaqësues nga Dragashi në mekanizmin koordinues të Prizrenit, as edhe një zyrtar për BGJ. Strehimorja ka kapacitet për 15-20 gratë dhe fëmijë (djemtë vetëm deri në moshën 12 vjeçare).

Strehimorja punëson 12 persona: këshilltarë; psikolog; edukatore; Trajner për TIK; trajner për ekonomi familjare; infermiere dhe drejtor. Të mbijetuarat e DhF mund të qëndrojnë maksimum deri në 6 muaj, por në disa raste kur ato nuk kanë ku të shkojnë ato qëndrojnë më

gjatë. Në vitin 2011, janë strehuar 50 gra. Anëtarët e stafit janë punësuar që nga koha e hapjes së strehimores, kështu që ata janë të trajnuar dhe me shumë përvojë.

Financimi është bërë kryesisht nga donatorët ndërkombëtarë (IOM, UNDP, UNFPA, OSBE, ASB nga Gjermania), por strukturat shtetërore në nivel qendror dhe lokal kanë mbështetur gjithashtu funksionimin e kësaj strehimore. Pra, MPMS-ja mbështet një pjesë të kostove (dmth 1250 euro në muaj). Ndërsa Komuna e Prizrenit ka paguar qiranë nga viti 2006 – 2011 dhe në vitin 2012 ka ofruar një ndërtesë e cila është renovuar me mbështetjen e Ambasadës së Holandës. Për shkak të mungesës së burimeve strehimorja u mbyll për 3 muaj në vitin 2006 dhe pasi fondet u siguruan, ajo u rihap gjithashtu si rezultat i kërkesës për shërbime të strehimit. Edhe pse ndodhet në Prizren, këtu janë strehuar jo vetëm gratë e regjionit të Prizrenit së bashku me fëmijët e tyre, por kur është e nevojshme edhe gra nga rajone të tjera. Është politikë e strehimores se të njëjtat gra nuk mund të akomodohen në strehimore për më shumë se 3 herë pasi që, sipas drejtorit ky bëhet një zakon për gratë t'i qasen strehimores madje edhe për problemet më të vogla. Gratë nga rajonet e tjera akomodohen gjithashtu, si dhe kur vendndodhja e të mbijetuarave të DhF identifikohet dhe ato nuk ndihen të sigurt dhe gjithashtu kur është i nevojshëm rotacioni për shkak të rregullit të qëndrimit maksimal prej 6 muajsh, në të njëjtën shtëpi strehuese.

Drejtoresha sqaroi se në lidhje me financimin e ardhshëm, ata janë në një proces intensiv të diskutimeve me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, në mënyrë që të përfshijë një linjë të veçantë buxhetore për financimin e shtëpive strehuese. Shuma minimale ka deklaruar ajo që I nevojitet një strehimore është 50,000 euro në vit. Drejtoresha theksoi se koalicioni i shtëpive strehuese në Kosovë (6 prej tyre) punon shumë mirë dhe ato janë duke lobuar fuqimisht për të garantuar financimin e strehimores për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre.

Sapo të pranohen në strehimore, të mbijetuarat e DhF kanë një pushim për 2-3 ditë, nënshkruajnë një kontratë dhe marrin një pako personale. Pas tri ditësh të mbijetuarat marrin orë konsultimi dhe gjithashtu marrin pjesë në kurset për kompjuter dhe ekonomi familjare.

Një kritikë e fuqishme e vërejtur ishte se Urdhri për Mbrojtje nuk funksionon në Kosovë, dmth se ligji nuk është implementuar plotësisht. Sipas Ligjit personi që ushtron DhF duhet të largohet nga shtëpia dhe jo e mbijetuara. Pas disa ditësh në burg personi i DhF kthehet në shtëpi dhe paraqet një rrezik për të mbijetuarën e DhF, pra largimi i të mbijetuarës së DhF nga vendi i dhunës mbetet alternativa më e sigurt. Re-integrimi i të mbijetuarës së DhF është problemi më i madh me të cilin ballafaqohen të mbijetuarit e DhF në Kosovë.

Në vitin 1999 Shoqata e parë e Grave është themeluar në **Gjakovë** me qëllim

të nxisë pozitën e grave në shoqëri dhe familje. Policia e Kosovës ka filluar të dërgojë të mbijetuarit e DhF në shoqatë. Në vitin 2000 shtëpia e parë strehuese e quajtur Shtëpia e Sigurt u krijua në Gjakovë për të mbështetur nënat dhe fëmijët e tyre që ishin objekt i dhunës dhe viktimave të trafikimit. Ka pasur katër faza të zhvillimit të strehimores: 1) Krijimi i infrastrukturave të strehimores; 2) zhvillimi i stafit; 3) krijimi i linjës SOS dhe 4) krijimi i mekanizmit koordinues për DhF.

Shtëpia e Sigurt ndërmerr aktivitetet e mëposhtme: strehimin; mbrojtje dhe siguri për të mbijetuarit e DhF; rehabilitimin (kujdes psikologjik, ligjor dhe mjekësor dhe aktivitete të tjera të përditshme); punën me familjet dhe ndërmjetësimin; zhvillimin profesional për të mbijetuarit e DhF (TIK; gjuhë angleze, artizanate, kultivimin e mjaltit, prodhimin e kremit nga mjalti dhe kultivimin e luleve, etj)

Përsa i përket re-integrimit të atyre grave që nuk kthehen në shtëpi, strehimorja paguan qiranë për dy vjet, energjinë elektrike dhe ujin. Në disa raste financohen shpenzimet e arsimit. Për fëmijët arsimimi vazhdon në shkollën më të afërt me strehimoren.

Përbërja e stafit të strehimores për vitin 2011 është si vijon:; 2 psikologë; një avokat; një edukatore për fëmijët; një këshilltar; një ekonomist; një mësues i gjuhës angleze; një këshilltar-student; Drejtori; një trajner për kurset e TI dhe një për artizanate. Punësimi për stafin profesional bëhet përmes konkursit dhe përzgjedhjes së bërë nga Bordi ndërsa

për postet e tjera të punëtorët punësohen nga Drejtori me miratimin e Bordit.

Strehimorja financohet nga donacionet dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kur shpallet tenderi, derisa nuk ofrohet asnjë mbështetje nga komuna edhe pse mbështetja gjithmonë premtohet. Ndërtesa është pronë e strehimores e financuar nga Caritas e Vjenës. Strehimorja mund të strehojë deri në 18 persona. Në vitin 2011 ka pasur 70 raste të strehimit, ndërsa në vitin 2012 deri më tani 40 raste.

Gjatë qëndrimit të tyre në strehimore gratë kujdesen për fëmijët e tyre, pastrojnë dhe përgatisin ushqimin për vete dhe fëmijët e tyre. Tri herë në javë ato kanë orë në palestër; një herë në javë punë në grupe; një herë në javë kanë seanca psikologjike që zgjasin deri në një orë; dy herë në javë kanë sesione me avokatin dhe në grupe; biseda me këshilltarët; vizita tek mjeku dhe gjinekologu sipas nevojës; puna në serra 45 minuta në ditë; një herë në javë qëndisje; dy herë në javë ndjekin kurse kompjuteri; puna me mjaltin e bletëve dhe përgatitja e kremit; ndjekin kurse parukerie tre herë në javë; dhe në mbrëmje ato shikojnë TV.

Strehimorja Liria në **Gjilan** është e një natyre të mbyllur që nënkupton se gjatë qëndrimit të tyre në shtëpinë strehuese gratë nuk largohen nga strehimorja përveçse të shoqëruara nga stafi I strehimores: për shembull nëse viktimat ka nevojë për trajtim mjekësor ajo do të shoqërohet nga stafi i strehimores. Në të gjitha shtëpitë strehuese viktimat dhe

fëmijët e tyre mund të strehohen, por jo djemtë më të moshuar se 12 vjet, pasi që në strehimore strehohen gjithashtu vajzat e pjekura. Kohëzgjatja e zakonshme e qëndrimit në strehimore është 6 muaj pas së cilës bëhet koordinimi me strehimoret tjera rajonale për të gjetur një vend për gratë. Megjithatë është vërejtur se ka raste kur viktimat qëndrojnë për më shumë se 6 muaj.

Strehimorja Liria ka 10 të punësuar: psikolog; sociolog; dhe edukatore. Stafi është i kualifikuar dhe konkurset shpallen për profesione të veçanta që plotësojnë kërkesat e strehimores. Komuna ka siguruar ndërtesën; dhe mbulon shpenzimet e ngrohjes dhe të mirëmbajtjes. Komuna ka investuar në ndërtesë për ta përshtatur atë me nevojat e strehimores. Komuna ka premtuar të ofrojë një tokë për të ndërtuar një shtëpi strehuese e cila do të ndërtohet me kontributin e komunës të donatorëve. Aktualisht Caritas nga Austria është duke financuar kostot e tjera të strehimores. Strehimorja vuri në dukje se në vendet e tjera strehimoret financohen nga buxheti i qeverisë dhe kjo mbetet çështja më e madhe që e vë në rrezik qëndrueshmërinë e strehimores. Përfaqësuesi nga strehimorja vuri në dukje se duke pasur parasysh se ka 6 strehimore në Kosovë 100.000 euro për strehimore do të ishin të mjaftueshme për të plotësuar nevojat bazë dhe që kjo nuk është një barrë e madhe për buxhetin. Kapaciteti aktual i strehimores Liria është 20 persona. Në vitin 2011 ka pasur 141 persona të strehuar nga të cilat 79 ishin femra dhe

në vitin 2012 ka pasur 39 persona të akomoduar.

Gjatë qëndrimit të tyre në shtëpinë strehuese, varësisht nga niveli arsimor, të mbijetuarat e DhF janë trajnuar në kompjuterë; kuzhinë; dhe bëjnë aktivitete tjera brenda strehimores.

Trajnimi bëhet nga stafi i strehimores; ushtrimet në palestër janë të organizuara brenda shtëpisë strehuese. Stafi i strehimores gjithashtu monitoron viktimat që janë larguar nga strehimorja dhe atë për 1 (një) vit pas datës së largimit. Ata do të vizitojnë viktimën kudo që ajo qëndron për të kontrolluar nëse ajo ka qenë subjekt i dhunës dhe gjithashtu bëhen përpjekje për të punësuar të mbijetuarit e mëparshëm. Është paraqitur një rast ku janë ndarë fonde nga Caritas nga Luksemburgu dhe komuna për të ofruar grante për trajnime dhe bizneset fillestare, kryesisht në fushën e bujqësisë. Strehimorja ka bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Arsimit dhe Shëndetësisë në komunë për të mbështetur viktimat dhe fëmijët e tyre për të vazhduar shkollimin e tyre dhe për viktimat të marrin mbështetjen e nevojshme mjekësore.

Re-integrimi i të mbijetuarave të dhunës në familje

Një nga sfidat me të cilat përballen strehimoret është re-integrimi i të mbijetuarave të dhunës në familje dhe kjo për dy arsye kryesore: së pari, ekziston një rrezik për të punësuar të mbijetuarat e DhF pasi ka pasur raste që të mbijetuarit e DhF janë sulmuar rrugës duke shkuar tek punëdhënësit i

tyre dhe e dyta pasi që ekziston mungesa e vendeve të punës në përgjithësi në Kosovë, gjë që e bën më të vështirë për të gjetur vende të punësimit. Përveç shumë pak rasteve të suksesshme, çështja e re-integrimit u theksua si një nga mangësitë më të shënuara në lidhje me shërbimet e ofruara për të mbijetuarit e DhF nga Rames (2012). Gjetja e strehimit të përhershëm/zgjidhja afatgjatë për të mbijetuarit e DhF është një sfidë e madhe dhe e kushtueshme dhe shumë pak është bërë në këtë drejtim. Sipas zyrtares të ABGJ komunat duhet t'i japin prioritet të mbijetuarve të DhF gjatë ndarjes së apartamenteve sociale për strehim social për njerëzit në nevojë - ajo pohoi se nuk duhet të ketë apartamente sociale për strehim për të mbijetuarit e DhF, por atyre duhet t'i jepet prioritet.

5.

Proceset e planifikimit buxhetor

5.1 Përshkrimi i buxhetit dhe procedurat për përgatitjen e buxhetit komunal

Informacionet e paraqitura në këtë seksion rrjedhin nga Ligjet ekzistuese

mbi buxhetin dhe financat dhe gjithashtu nga intervistat e kryera me: Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencinë për Barazi Gjinore dhe tri komunat e përfshira në këtë projekt.

Buxheti i Kosovës përbëhet nga katër kategori kryesore: pagat; mallrat dhe shërbimet; investimet kapitale; transferet dhe subvencionet dhe shërbimet komunale. Buxheti është llogaritur për secilën ministri, komunë dhe institucionet tjera qeveritare. Përgatitja e buxhetit në Kosovë fillon në janar dhe rendi i procedurave është si më poshtë: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve është përgatitur nga njësia makroekonomike; komiteti I granteve përgatit qarkoren e parë me limitet e buta në bazë të kategorive ekonomike: pagat; mallrat dhe shërbimet; investimet kapitale; transferet dhe subvencionet dhe shërbimet; qarkorja e dytë lëshohet me limite më të ashpra; në disa raste, nëse ndryshimet janë të nevojshme mund të lëshohen më shumë qarkore; komunat e përgatisin buxhetin në grupin e modeleve sipas limiteve të caktuara; buxheti përfshin projekte që do të financohen; Ministria e Financave finalizon buxhetin dhe qeveria lokale nuk mund të bëjë ndryshime, por mund të caktojë një kërkesë apo ankesë tek komisioni i granteve e cila edhe mund të refuzohet.

Burimi kryesor i të ardhurave në komuna është granti i përgjithshëm I marrë nga qeveria: në vitin 2012 vetëm 17% e të ardhurave ishin nga të hyrat vetanake të komunave. Komunat pranojnë Grante Operative nga Buxheti i

Republikës së Kosovës, dhe këto janë: Granti i Përgjithshëm, Granti Specifik për Arsim dhe Granti Specifik për Shëndetësi, duke përfshirë edhe shëndetësin dytësore. Grantet bazohen në kriteret e drejta, transparente dhe objektive, duke i dhënë në këtë mënyrë komunave pavarësi më të madhe në alokimin dhe shpenzimin e tyre. Komunitet gjatë kësaj marrin nga financimi i nivelit qendror për transferimin e kompetencave të shtuara dhe të deleguara dhe asnjë nga pilot komunitet nuk merr një grant të tillë. Indikatorët e përdorur për alokimin e Grantit të Përgjithshëm në komuna janë: Popullsia llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind e alokimit (89%); Numri i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë (3%); komunitet, në të cilat shumica e popullsisë janë të përbërë nga anëtarë të komunitetit pakicë (2%). Formula e financimit për grantin e Arsimit përfshin: alokimi komunal = Pagat për arsimtarët + Pagat për personelin administrativ dhe ndihmës + Mallrat dhe Shërbimet + kapitalet e vogla. Përcaktimi i Granti Specifik për Shëndetësi bazohet në formulën për kokë banori, numrin e vizitave shëndetësore dhe koston mesatare për vizitë. Përshtatjet në parametrat e formulës janë bërë për të marrë parasysh rritjen nominale të popullsisë, inflacionin dhe koston e ofrimit të kujdesit shëndetësor parësor. Kriteret e aplikuar janë: mesatarja e vizitave për kokë banori, shumëzuar me koston e vizitës duke përfshirë inflacionin, shumëzuar me numrin e banorëve që rezultojnë në Grantin Specifik të Shëndetësisë Primare.

Ligjet dhe dokumentet kryesore në lidhje me buxhetimin në nivel lokal janë:

1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP)
2. Ligji për Financat e Qeverisjes Lokale
3. Ligjet e Buxhetit Vjetor dhe publikimi i Buxhetit Vjetor
4. Buxheti Afatmesëm Komunal (BAK) I cili është për procesin e planifikimit për tre vite
5. Udhëzuesi i Ministrisë së Financave për procesin e planifikimit të Buxhetit të Kosovës

Fazat dhe afatet për përgatitjen e buxhetit komunal përfshijnë:

1. Përgatitja e Buxhetit Afatmesëm Komunal (KAB) - deri më 30 qershor
2. Zhvillimi i qarkores së parë të brendshme buxhetore komunale
3. Zhvillimi i qarkores së dytë të brendshme buxhetore komunale: limitet e buxhetit fillestar për programe specifike dhe kalendari buxhetor-deri më 1 korrik
4. Paraqitja e propozimit të buxhetit sipas programeve
5. Zhvillimi i qarkores së dytë të brendshme buxhetore komunale; kalendari dhe udhëzimet për dëgjimet buxhetore të brendshme
6. Zhvillimi i dokumenteve për propozim të buxhetit
7. Dorëzimi i propozimit të buxhetit në Kuvendin Komunal - deri më 1 shtator

8. Miratimi i buxhetit nga Kuvendi Komunal dhe dorëzimi në Ministrinë e Financave deri më 30 shtator

Një organ i rëndësishëm në lidhje me buxhetimin në komuna është Komisioni për Politikë dhe Financa. Sipas Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të miratuar në vitin 2008, neni 52 përcakton përbërjen dhe përgjegjësitë e Komisionit për Politikë dhe Financa. Komisioni për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe përbërja e tij pasqyron përfaqësimin e entiteve politike në Kuvendin Komunal.

Komisioni për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën Afatmesme Buxhetore Vjetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës të auditimit të brendshëm, buxhetin afatmesëm vjetor dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe raportet nga Kryetari I komunës dhe I paraqet rekomandimet për veprim në Kuvendin Komunal.

Deri në janar të vitit 2009 Shërbimet Sociale ishin përgjegjësi e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të ofruara nga Qendrat e tyre për Punë Sociale që do të thotë se të gjitha Shërbimet Sociale janë menaxhuar nga qeveria qendrore përkatësisht ishin të centralizuara. Me Memorandumin e Mirëkuptimit nga 1

shkurti 2009 - të nënshkruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave (MF) dhe komunat e Kosovës - Qendrat për Punë Sociale (QPS) u bënë pjesë e administratës komunale dhe Departamentet Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale u bënë në përgjithësi përgjegjëse për të siguruar ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare 2005. Këto përgjegjësi të reja mbuluan fazat e planifikimit, buxhetimit dhe mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve sociale. Megjithatë, jo të gjitha Shërbimet Sociale edhe pse ishin të centralizuara, disa u bënë përgjegjësi të deleguara të komunave dhe disa madje mbetën të centralizuara.

Në këtë organizatë të re MPMS-ja mban të gjithë funksionin mbikëqyrës për të gjitha Shërbimet Sociale të ofruara nga komunat, rolin e saj në politikë për funksionet e deleguara dhe mbetet plotësisht përgjegjëse për shërbimet sociale të centralizuara. Bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, komunat marrin një Grant të Përgjithshëm dhe dy grante specifike – njëri i dedikuar për Shëndetësi dhe tjetrin për Arsim. Nuk është bërë asnjë grant specifik për ofrimin e Shërbimeve Sociale (DFID, 2011).

Sipas DFID (2011) krahas mungesës së përgjithshme të burimeve për shërbimet sociale në Kosovë, një tjetër faktor i rëndësishëm është mungesa e kriterëve të mjaftueshme për shpërndarjen e

fondeve në mes të Drejtorive të ndryshme Komunale dhe gjithashtu në mes të Njësive të Mirëqenies Sociale dhe Njesisë për Shëndetësi në kuadër të komunave. Në mënyrë të ngjashme në nivel qendror, variablat / treguesit e përdorur për alokim për Grantin e Përgjithshëm janë të bazuar thjesht në numrin e popullsisë të komunave (DFID, 2011). Pritet që kjo dobësi mund të përmirësohet me të dhënat më të fundit dhe të shumëllojshme nga regjistrimi 2011.

Pas decentralizimit Departamentet Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DKSHMS) janë caktuar të implementojnë rregulloret dhe aktet tjera juridike nga fushat e kujdesit shëndetësor parësor dhe të mirëqenies sociale. Bazuar në procesin e decentralizimit këto Drejtori organizojnë dhe monitorojnë ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare brenda territorit të tyre përmes aktiviteteve të QPS-ve. Çdo komunë në Kosovë, është e obliguar për të kandiduar të paktën një QPS.

Figura 1: Struktura e Qendrave për Punë Sociale



Shërbimet e ofruara nga QPS-të për të mbijetuarit e DhF janë të lidhura me pajtimin mes çiftit dhe gjithashtu të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve nëse ata konsiderohen në rrezik dhe nëse asnjë nga prindërit nuk i dëshiron fëmijët. QPS-të kanë një linjë telefonike të hapur 24 orë, një staf që merr pjesë gjatë intervistimit të mbijetuarës të DhF. Punonjësit socialë të QPS thirren nga policia për të marrë marr pjesë në intervistë. Është kuptuar se stafi social i

QPS-të nuk janë të specializuar dhe të angazhuar vetëm për shërbime për të mbijetuarit e DhF, por në të gjitha shërbimet që janë të ofruara nga QPS-të (që janë rreth 50 në total).

Mangësitë dhe sfidat në lidhje me shërbimet e ofruara nga QPS-të në tri komunat e përfshira janë identifikuar nga Rames (2012) të listuara më poshtë

- QPS-ja ofron asistencë për të mbijetuarit të cilët i plotësojnë

kriteret për skemat e përgjithshme të ndihmës sociale. Ky mekanizëm nuk është përshtatur për të dhënë ndihmë emergjente për viktimat e dhunës në familje;

- QPS-ja ofron disa këshilla dhe menaxhimin e rasteve, por kryesisht për mbrojtjen e fëmijëve. Ajo fokusohet kryesisht në pajtimin e rasteve të dhunës në familje, madje edhe kur kjo nuk është në interesin më të mirë të mbijetuarës;
- QPS-ja nuk ka buxhet për nevojat emergjente apo për riintegrim;

Që nga viti 2009 me decentralizimin të gjitha komunat në Kosovë së bashku marrin 2 milionë euro që shkon në grantin e përgjithshëm, por që është për të financuar QPS-të nga MPMS (intervista e zhvilluar me Shefin e Divizionit të Analizave Buxhetore dhe Vlerësimit të Varfërisë në MPMS). Llogaritja Buxheti është bërë nga komunat dhe MPMS alokon buxhetin për secilën komunë. Komunat e llogarisin buxhetin bazuar në vitet e mëparshme, por deri më tani ato nuk përdorin të dhëna mbi dhunën në familje si informacion për llogaritjen buxhetit. Pra, përfundimi është se llogaritja e buxhetit për QPS-të është plotësisht nën diskrecionin komunal dhe ka vend për të ndërhyrë atje nëse buxheti për DhF do të alokohet. Sipas Mentorit komunat mund të shpallin një tender dhe të blejnë shërbime nga OJQ-të në lidhje me DhF.

Sipas QPS buxheti për Qendrat është përcaktuar nga MPMS dhe komuna

pranon një buxhet vetë për pagat e QPS-ve dhe për shpenzimet operative. Për shkak të praktikitetit drejtori i Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Prishtinë u intervistua për të kontrolluar nëse komuna ka liri veprimi në vendosjen e buxhetit për QPS-të siç thuhet nga MPMS. Në kundërshtim me atë që thuhet nga MPMS drejtori deklaroi se ata nuk e vendosin buxhetin, por ka përpjekje për të ndryshuar - që të ketë një grant të veçantë për shërbimet sociale të cilat janë penguar me sistemin ekzistues dhe buxhetin. Komunat pjesë e grantit të përgjithshëm marrin buxhetin për paga dhe shpenzimet operative të qendrave, por nuk ka buxhet për shërbimet dhe mbështetjen që mund të ofrohen për shembull për të mbijetuarit e DhF. Është thënë se UNDP-ja ka mbështetur një projekt të kryer nga RrGGK për të llogaritur shpenzimet për shërbimet sociale të ofruara për të mbijetuarit e DhF që mund të përdoret si një e dhënë e mirë hyrëse për alokimin e buxhetit në komuna. Raporti është publikuar në shtator 2012.

Që nga viti 2006 deri në vitin 2009 shtëpitë strehuese në Kosovë janë financuar nga MPMS në bazë të MoU, por nga viti 2009 MPMS-ja shpall thirrje për tender për të blerë shërbime nga OJQ-të për të strehuar të mbijetuarat e DhF. Strehimoret janë paguar 50% të kostove të tyre - që janë shërbimet e blera nga Ministria. Deri në vitin 2012 mbështetja ishte 1,250 euro në muaj derisa në vitin 2012 kjo është rritur në 2,000 euro në muaj. Strehimoret nuk janë mbështetur për pagat e stafit, por për ushqim, higjienë, rehabilitim,

shërbime psiko-sociale dhe shërbime të ngjashme. Mbështetja financiare nga MPMS-ja është bërë nga kategoria e shpenzimeve të subvencioneve. Është vërejtur se strehimoret ankohen se shpenzimet e stafit nuk janë të mbuluara dhe nëse nuk gjenden donacione kjo mund të sjellë mbylljen e strehimoreve.

Angazhimi për të mbështetur shtëpitë strehuese është vërejtur edhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2013-2015, sipas të cilës për të arritur objektivin: "për rritjen e mirëqenies dhe mbështetja e familjeve, përmes ofrimit të ndihmave sociale dhe shërbimeve sociale për kategoritë e rrezikuara", MPMS-ja planifikon të implementojë financimin e 7 strehimoreve për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, duke blerë shërbime të tilla nga OJQ-të, dhe me bashkëfinancim me donatorë.

Propozimi nga MPMS është që të krijojë një grant të veçantë për QPS-të duke përfshirë edhe shërbime për të mbijetuarit e DhF gjë e cila do të llogaritet bazuar në të dhëna hyrëse të besueshme në bazë të cilave do të bëhen alokimet buxhetore për secilën komunë. Megjithatë Ligji ekzistues mbi Financat e Pushtetit Komunal nuk lejon krijimin e një granti të tillë. Një zhvillim i rëndësishëm i vërejtur është se MPMS do të fillojë certifikimin e punëtorëve social në Kosovë, gjë e cila do të sigurojë garantimin e cilësisë pasi deri më tani nuk kishte certifikime, prandaj asnjë masë nëse shtëpitë strehuese dhe ofruesit tjerë të shërbimeve nuk ka punuar sipas standardeve.

Sipas Rames (2012) edhe pse Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka më shumë fleksibilitet, sepse buxheti i saj është menaxhuar në nivelin komunal në praktikë, megjithatë, ajo ofron shumë pak mbështetje për të mbijetuarit me disa përjashtime të rralla. Këto përfshijnë pagesën e qirasë për dy të mbijetuar në Gjilan dhe ndërtimin e një shtëpie për një të mbijetuar në Gjilan (me mbështetje nga një donator ndërkombëtar dhe buxheti për subvencione nga Kryetari i Komunës) (Rames, 2012).

Shefi ekzekutiv dhe zyrtarët nga ABGJ thanë se Agjencia nuk është i përfshirë në ndonjë proces të buxhetimit për DhF dhe gjithashtu nuk raporton dhe nuk pranon raporte për DhF nga komunat. Në korrik të vitit 2012 koordinator kombëtar për monitorimin e implementimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje u emërua (Zëvendësministër i Ministrisë së Drejtësisë i cili i raporton Qeverisë së Kosovës), i cili do të ndjekë dhe monitorojë implementimin e strategjisë, ku objektivat, aktivitetet dhe institucionet përgjegjëse janë të përcaktuara. U theksua se Ligji për Barazinë Gjinore do të përfshijë buxhetimin gjinor si një nga nenet, për të cilin ABGJ ka nevojë, përveç rezervave që ata kanë për implementimin e saj. Megjithatë ata e konsiderojnë këtë si një hap të parë të duhur. Sa i përket buxhetimit në nivel lokal një nga zyrtarët e Agjencisë ka deklaruar se buxheti për DhF është përgjegjësi e MPMS-së prandaj nuk ka nevojë që të ketë në nivel lokal. U theksua se tentativa e ABGJ është të krijohen Zyra

për Barazi Gjimore në Komunitat të cilat do të kenë buxhetin e tyre dhe kështu mund të financojnë aktivitetet për DhF. Aktualisht zyrtarët për BGJ janë nën Njësinë për të Drejtat e Njeriut me asnjë linjë të veçantë të buxhetit dhe zakonisht zyrtarët për BGJ mbajnë një tjetër detyrë si pjesë e Njësisë dhe si rezultat aktivitete të kufizuara në zonën e BGJ.

5.2 Procedurat e buxhetit komunal: si janë përcaktuar prioritetet dhe si janë bërë alokimet: gjetjet nga intervistat

Pas shpjegimit të procedurave të buxhetit në seksionin e mësipërm, në këtë seksion informacionet e mbledhura nga intervistat me Departamentin e Financave në tri komuna janë paraqitur duke u fokusuar kryesisht në atë se si është përcaktuar buxheti dhe si janë caktuar prioritetet.

Sipas komunës së Gjilanit, komuna pranon qarkore buxhetore nga Ministria e Financave e cila dërgohet në Departamente. Limitet tashmë janë caktuar nga Ministria për paga dhe mëdijtje, mallra dhe shërbime, shërbime dhe subvencione. Në komunën e Gjilanit kërkesat nga departamentet analizohen nga Kryetari i Komunës dhe Komisioni për Politikë dhe Financa e cila rregullohet me ligjin e qeverisjes lokale. Komisioni është organi kryesor që

miraton buxhetin dhe e dërgon atë në kuvendin komunal për miratim. Është deklaruar se ka pasur ndryshime të vogla në buxhet nga viti në vit për shkak të limiteve buxhetore që ka Kosova. Tendenca është që shumica e shpenzimeve janë në investime kapitale. Brenda limitit të caktuar për investime kapitale limitet janë caktuar nga departamentet të cilat duhet të propozojnë idetë për projekt - të cilat dërgohen më pas në Zyrën për projekte për shqyrtim. U deklarua se për shkak të ndërtimit të autostradës buxheti i komunës për investime kapitale është zvogëluar. Është treguar se buxheti është i vogël dhe ekziston pak fleksibilitet për komunën edhe për faktin se rreth 70 për qind e buxhetit vjen nga qeveria qendrore dhe vetëm 30 për qind është nga burimet vetanake të komunës.

Pasi buxheti është pajtuar nga Kryetari i Komunës, ekipi Komisionit për Politikë dhe Financa (përbëhet prej grupit parlamentar me përfaqësues nga të gjitha partitë politike: Kryetari + 3 nga PKD (tani në pushtet); 3 nga LDK-ja, dhe 1 nga AAK dhe AKR : kjo është e rregulluar me ligj: ADD) organizon dëgjimin publik me qytetarët e komunës së Gjilanit.

Gjatë intervistës në Dragash u theksua se hapi i parë është zhvillimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve e cila dorëzohet në Kuvendin Komunal për diskutim. Hapi i dytë përfshin përcaktimin e prioritetëve nga drejtorët e departamenteve. Në hapin e tretë caktohen limitet e para të buxhetit dhe vazhdon me përgatitjet e buxhetit deri

më 30 shtator, kur buxheti aprovohet. Kryetari deri më 1 shtator paraqet propozimin buxhetor në Kuvendin Komunal dhe Kuvendi përcakton prioritetet në bazë të propozimeve të bëra nga Kryetari i Komunës. Buxheti zhvillohet bazuar në buxhetet e viteve të kaluara. Është deklaruar se raportet vjetore për vitet e mëparshme janë burim i rëndësishëm i informacionit gjatë përgatitjes së buxhetit pasi kjo mundëson eliminimin e mangësive nga vitet e mëparshme.

Nga intervista e realizuar në Gjakovë është vërejtur se buxheti është përgatitur në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësitë. Komuna përgatit buxhetin në bazë të qarkoreve për çdo vit të përgatitur nga Ministria e Financave. Prioritetet përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni për Politika dhe Financa; Kuvendi Komunal dhe dëgjimet publike të organizuara në zonat urbane dhe rurale. Buxheti është përshtatur duke përdorur edhe Strategjinë për Zhvillimin Ekonomik të Komunës dhe Planin e Zhvillimit Urban dhe Rural. Të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet e secilit departament nga vitet e fundit përdoren si bazë e fuqishme.

Ndryshe nga Dragashi dhe Gjlani, komuna e Gjakovës drejton Bordin e Drejtorëve të cilët takohen një herë në javë dhe udhëhiqet nga Kryetari i Komunës. Në këto takime marrin pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, nënkryetari i komunës, drejtorët e të gjitha departamenteve, zyrtari për Zyrën e barazisë gjinore, si dhe kreu i Komisionit për komunitete dhe të

kthyer, si dhe zyrtari për informim. Në këtë takim të gjithë pjesëmarrësit i raportojnë Kryetarit të Komunës në lidhje me aktivitetet e tyre. Në këto takime të gjitha kërkesat e organeve të ndryshme në kuadër të komunës, duke përfshirë ato që vijnë nga shoqëria civile vlerësohen në këto takime dhe vendimet miratohen nga Kryetari i Komunës. Para kësaj, Bordi i Drejtorëve pranon dokumentet lidhur me kërkesat të cilat diskutohen më pas. Të gjitha vendimet e marra dhe procesverbalet publikohen në faqen e internetit.

6. Alokimet financiare në nivel lokal për përgjigje ndaj Dhunës në Familje: gjetjet nga intervistat

Pasi që fokusi i këtij raporti ka të bëjë me buxhetimin për dhunën në familje, gjatë intervistave me drejtuesit e Departamenteve të Financës, është adresuar një pyetje nëse komunat e alokojnë buxhetin për aktivitetet që lidhen me mbrojtjen dhe re-integrimin dhe aktivitetet tjera që lidhen me të mbijetuarit e DhF. Gjetjet nga intervistat janë paraqitur në këtë seksion.

Në Gjiilan është thënë se nuk ka linjë buxhetore për dhunën në familje. Komuna ka siguruar ndërtimin dhe shërbimet e qendrës paguhen nga linja buxhetore e shërbimeve komunale. Në mënyrë të ngjashme nuk ka linjë buxhetore për zyrat për Barazi Gjinore dhe projektet për çështje gjinore, por në raste kryetari financon projekte kur buxheti e lejon këtë. Zyrtari për Barazi Gjinore ofron disa shembuj kur Kryetari I Komunës nga buxheti I zyrës së tij ka financuar strehimin dhe shpenzimet për dru për një të mbijetuar të dhunës në familje, e cila pas qëndrimit për 6 muaj në strehimore ajo nuk kishte asnjë vend për të shkuar. Kryetari i komunës ka sponsorizuar edhe shtypjen e fletushkave për fushatën e vetëdijësimit për dhunën në familje. Të gjitha këto kanë ndodhur me vullnetin e Kryetarit për të mbështetur projektet për çështje gjinore.

Në Gjakovë nuk ka linjë buxhetore dhe alokim për DhF. I pyetur në lidhje me ndarjen e kohës të cilën zyrtarja e BGJ e shpenzon në shërbimet që kanë të bëjnë me dhunën në familje Drejtori deklaroi se ajo shpenzon shumë kohë në lidhje me DhF dhe gjithashtu merr pjesë në të gjitha dëgjimet publike për buxhetin. Megjithatë, sipas zyrtares për BGJ shumë pak kohë shpenzohet në mbështetjen e të mbijetuarit të DhF . Në vitin 2011 komuna e Gjakovës ka mbështetur strehimoren 'Shtëpia e Sigurt' me 5000 euro dhe OJQ-të tjera mbështeten në varësi të projekteve të tyre dhe mundësive komunale.

Ngjashëm me dy komunat tjera, në Dragashi nuk ka buxhet të alokuar për

DhF as në 2011 as në vitin 2012 dhe deri më tani nuk është bërë ndonjë financim për DhF. Drejtori i Financave nuk është informuar për kohën që zyrtarja për BGJ shpenzon për aktivitetet që lidhen me DhF. Nuk ka linjë të veçantë buxhetore për të mbështetur OJQ-të, por projektet mbështeten nga transferet dhe subvencionet, siç paraqitet nga zyrtarja për BGJ por që përsëri varen nga burimet financiare. Sipas zyrtares për BGJ asnjë projekt nuk është financuar deri më tani. Kur u pyet se si financohen shtëpitë strehuese, përgjigja ishte se QPS-të duhet pyetur për këtë. Aktualisht nuk ka strehimore në Dragash, por ajo në Prizren mbulon Dragashin gjithashtu. Rajoni i Dragashit përdor strehimoren në Prizren dhe nga intervista me Drejtoreshën e strehimores në Prizren është treguar se ata kurrë nuk kanë qenë në kontakt me zyrtarët e Dragashit dhe asnjë mbështetje nuk është pranuar nga ata.

7.

Procesi me pjesëmarrje në lidhje me përgatitjen e buxhetit në nivel

komunal: gjetjet nga intervistat

Neni 68 mbi Informimin dhe Konsultimin Publik i Ligjit Nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale i miratuar në vitin 2008 deklaroi që secila komunë mban periodikisht, së paku dy herë në vit, takime publike në të cilat çdo person apo organizatë me interes në komunë mund të marrë pjesë. Data dhe vendi i takimit publikohet së paku dy javë më herët. Një nga mbledhjet mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Artikulli megjithatë nuk tregon se një takim duhet të jetë rreth propozimit të buxhetit.

Sipas drejtorit të Financave në Gjiçan në dëgjimin publik Komisioni për Politikë dhe Financë dhe Drejtorët e të gjitha Departamenteve marrin pjesë, ndërsa zyrtari nga Zyra për Barazi Gjinore marrë pjesë si vëzhgues. Kur u pyet në lidhje me gjininë e pjesëmarrësve të përmendur më lartë u tha se për shumë vite (7-8 vjet) të gjithë anëtarët e ekipit janë meshkuj-siç është deleguar nga të gjitha partitë politike. Buxheti është paraqitur në Euro, por vetëm shuma totale për grupin e investimeve kapitale pasi sipas Drejtorit të Financave, ky është lloji i vetëm i shpenzimeve ku ekziston fleksibiliteti për ndryshime. Ishte befasuese se vetëm një listë e projekteve është paraqitur pa shumën e secilit projekt. Dëgjimi publik mbahet një herë në vit dhe kjo vetëm në një vend që është në sallën e kuvendit komunal. Sa i përket pjesëmarrësve u

theksua se edhe pse informacioni është shpërndarë në tërë komunën, duke përfshirë zonat rurale (me tabela dhe publikohet në faqen e internetit) në këto dëgjime publike në shumicën e rasteve pjesëmarrësit janë zyrtarët komunalë të cilët diskutojnë në emër të komunitetit nga ku ata vijnë. Asnjë grua dhe asnjë OJQ nuk merr pjesë ndonjëherë në këto dëgjime. Në këto dëgjime pjesëmarrësit komentojnë dhe bëjnë propozime në lidhje me projektet e investimeve kapitale. Bazuar në përvojën, propozimet ishin për të ndërtuar një shkollë, për të ndërtuar një rrugë dhe propozime të ngjashme. Duke marrë parasysh komentet dhe propozimet mund të ndodhë të bëhen ndryshime edhe pse shumë rrallë dhe pas aprovimit nga Kuvendi Komunal dhe Ministria e Financave buxheti publikohet në faqen e internetit. Nuk ka asnjë informacion për ata që bëjnë propozime - edhe pse kjo nuk është e aplikueshme duke pasur parasysh se vetëm zyrtarët komunalë marrin pjesë në dëgjimet publike.

Ishte interesante se informacioni i dhënë nga zyrtarja nga Zyra për Barazi Gjinore në Gjiçan ishte shumë i ndryshëm nga Drejtori i Financave në lidhje me pjesëmarrjen e grave në dëgjime publike. Ajo ka deklaruar se rreth 20% e pjesëmarrësve janë femra derisa Drejtori theksoi se qytetarët nuk marrin pjesë, vetëm zyrtarët. Zyrtarja për BGJ ka deklaruar se ajo është një anëtare e përhershme në ekip gjatë dëgjimeve publike, derisa Drejtori sqaroi se ajo është vetëm një vëzhgues.

Sa i përket procesit me pjesëmarrje në përshtatjen e buxhetit komunal, komuna

e Gjakovës organizon dëgjim publik me qytetarët e Gjakovës. Informacioni për dëgjimin publik ofrohet me anë të mediave të radios lokale dhe stacioneve televizive. Disa OJQ marrin pjesë, megjithatë ato nuk ftohen drejtpërdrejtë, por në mënyrë të ngjashme si qytetarët, përmes mediave. Dëgjimet publike mbahen në sallën e kuvendit komunal, ndërsa në zonat rurale në shkolla dhe ndërtesa kulturore. Në dëgjimet publike marrin pjesë si në vijim: Kryetari i Komunës, kryetari i kuvendit, Drejtori i Financave dhe Zhvillimit, Zyrtarja për BGJ, etj. Sipas Drejtorit të Financave në dëgjimet publike gratë janë të përfaqësuara përmes OJQ-ve, por kjo nuk është deklaruar nga zyrtarja për BGJ. Buxheti paraqitet në Euro dhe në përqindje. Kryesisht propozimet kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës. Sa për rekomandimet që lidhen me DhF, Drejtori deklaroi se propozimet kuhej të kishin lidhje me shërbimet sociale për të mbijetuarit e DhF. Rekomandimet janë marrë në konsideratë në bazë të mundësive fiskale komunale.

Dëgjimi publik në Dragash gjithashtu është përdorur si një mekanizëm për procesin me pjesëmarrje në përgatitjen e buxhetit. Informacionet për dëgjimin publik shpallen përmes mediave lokale dhe nuk ka ftesa të veçanta që dërgohen për OJQ-të. Takimet mbahen në sallën e kuvendit komunal. Të gjithë individët e interesuar nga komuna mund të marrin pjesë dhe gjithashtu edhe zyrtarja për BGJ. Është thënë se ekziston pjesëmarrje e ulët në dëgjimin publik dhe thuhet se grate dhe OJQ-të marrin pjesë, por kjo nuk është konfirmuar nga zyrtarja për

BGJ, gjë e cila është e rëndësishme që asnjë grua nuk merr pjesë në këto dëgjime. Buxheti paraqitet në vlera absolute. Propozimet kryesisht kanë të bëjnë me projektet e infrastrukturës. Personi i intervistuar nuk mbante në mend asnjë rast kur propozimet janë bërë në lidhje me DhF. Propozimet analizohen dhe nëse janë bërë ndryshime, buxheti final publikohet në faqen e internetit të komunës.

8.

Burimet njerëzore aktive në përgjigje ndaj DhF në komuna: Zyrtarja Për Barazi Gjinore

Në komunën e Gjilanit zyrtarja për BGJ nuk e ka dhunën në familje, si pjesë të përshkrimit të punës së saj dhe ajo gjithashtu konfirmoi se nuk ka linjë të veçantë buxhetore për projekte gjinore dhe DhF. Zyrtarja për BGJ shpjegoi se ekziston një grup punues i cili ka nënshkruar një MoU në mes të anëtarëve të mekanizmit koordinues dhe komunës të cilët diskutojnë çështje që lidhen me DhF në takimet e rregullta ku zyrtarja për BGJ është një anëtare. Pyetur për raportimin ajo ka deklaruar se të gjithë anëtarët e grupit punues raportojnë për fushën e tyre të punës dhe pastaj ajo i raporton Kryetarit të

Komunës dy herë në vit. Kur u pyet nëse ajo ka kërkesa për buxhetin, ajo deklaroi se po, por kërkesat e saj kanë më shumë lidhje me furnizimin për zyrë. Megjithatë, ajo ka thënë se ajo ka kërkuar nga buxheti për të mbështetur të mbijetuarit e dhunës në familje pasi ato të largohen nga strehimorja. Mirëpo kur u pyet për dokumentacionin, vetmi dokument i ofruar ishte MoU dhe nuk u ofrua asnjë raport apo procesverbal.

Në Gjilan një intervistë u realizua edhe me Koordinatorin e Njesisë për të Drejtat e Njeriut pjesë e së cilës është zyrtari për BGJ. Ai shpjegoi se përshkrimi i tij të punës nuk përfshin detyrat në lidhje me DhF dhe gjithashtu konfirmoi se komuna nuk ka buxhet për DhF as për njësinë e tij. Pasi ai është duke punuar në Njësinë për një vit e gjysmë ai ende nuk ka arritur tek kërkesa për projekt propozim nga OJQ-të që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Në kundërshtim me zyrtarin për BGJ ai ka deklaruar se takimet e grupit punues u zhvilluan vetëm një herë gjatë një viti e gjysmë. I pyetur nëse ata janë të angazhuar në përgatitjen e buxhetit ai deklaroi se ata pothuajse asnjëherë nuk janë ftuar nga frika e pikëpamjes së tyre mbi qasjen për të drejtat e njeriut.

Në Gjakovë u tha se Zyrtarja për Barazi Gjinore shpenzon një sasi të konsiderueshme të kohës mbi aktivitetet që lidhen me dhunën në familje. Zyrtarja për BGJ ka deklaruar se ajo është aktive në mekanizmin koordinues ndërsa për aktivitetet ajo përmendi ditët për ngritjen e vetëdijësimit që organizohen çdo vit. Mungesa e buxhetit është theksuar si pengesa kryesore për të mbështetur të

mbijetuarit e dhunës në familje. U vu re se të mbijetuarit kontaktojnë kohë pas kohe me zyrtaren për BGJ për të kërkuar mbështetje, por për shkak të mungesës së fondeve mund të ofrohet mbështetje e vogël.

Në Dragash zyrtarja për BGJ ka deklaruar se nuk ka aktivitete në lidhje me DhF dhe asnjë mbështetje financiare. Zyrtarja për BGJ ka deklaruar se për shkak të buxhetit të limituar dhe mungesës së vullnetit pothuajse asgjë nuk është bërë deri më tani në fushën për çështje gjinore.

Në asnjë nga komunat përshkrimi I vendit të punës për zyrtarin për BGJ nuk përfshin detyrat në lidhje me DhF, por sipas ABGJ edhe pse përshkrimi I punës së zyrtarit për BGJ nuk përfshin një shënim të veçantë mbi DhF kuptohet se ajo është pjesë e detyrës së tyre.

Gjatë leximit të Buletinit të publikuar në vitin 2012 nga ABGJ është vërejtur se Zyrtari për Barazi Gjinore në Gjilan ka shpërndarë broshura dhe pamflete në të tri gjuhët për rëndësinë e raportimit të dhunës në familje. Në Gjakovë më 25 nëntor 2011 u organizua një debat mbi fenomenin e dhunës në familje. Megjithatë, nuk është vërejtur asnjë aktivitet në Dragash.

Zyrtarët e ABGJ kanë cekur se shumë varet nga ajo se sa aktive është një ZBGJ. Ata theksuan se komuna e Dragashi është e dobët, për këtë arsye mungon mbështetja në lidhje me DhF.

9.

Funksionimi i mekanizmit koordinues dhe niveli i njohjes së ofruesve të shërbimeve mbi Dhunën në Familje dhe Buxhetimin e Përgjithshëm

Gjinor: gjetjet nga sondazhi me anëtarët e mekanizmit koordinues

Gjetjet nga sondazhi me anëtarët e mekanizmit koordinues

Në tre komuna janë shpërndarë 23 pyetësorë dhe janë marrë 21 përgjigje. Rezultatet janë paraqitur më poshtë.


Njohuri mbi ligjet dhe dokumentet e lidhura me gjininë

Ligjet dhe dokumentet kryesore që kanë të bëjnë me çështjet gjinore, për të cilat të anketuarit kanë njohuri janë: Ligji për barazi gjinore; Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje; Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Ligji i Punës; Ligji kundër diskriminimit; Ligji për familjen; Ligji Penal; Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare; Ligji mbi mbrojtjen e fëmijëve; dhe Ligji mbi Trashëgiminë. Në lidhje me njohuritë me Strategjitë dhe Programet dokumentet më të njohura janë: Programi Kombëtar mbi Barazinë Gjinore; Programi Kombëtar kundër Dhunës në Familje dhe Strategjia kundër Trafikimit. Ka pasur disa raste ku nuk janë vërejtur strategji dhe plane. CEDAW, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1325, janë dokumentet ndërkombëtare më të njohura lidhur me çështjet gjinore. Megjithatë, edhe në këtë pyetje ka pasur të anketuar (rreth 30%) që nuk iu përgjigjën duke lënë të kuptohet se nuk kanë njohuri mbi dokumentet ndërkombëtare.

Të gjithë të anketuarit kanë deklaruar se kanë njohuri për Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Në pyetjen nëse të anketuarit janë trajnuar mbi standardet / rregulloret që kanë të bëjnë me dhunën në familje, 85 janë përgjigjur pozitivisht dhe

15 për qind deklaruan se ata nuk ishin të trajnuar (figura 1).

Figura 1: Nëse janë trajnuar mbi standardet / rregulloret lidhur me dhunën në familje



Funksionimi i Mekanizmave

Koordinues

Anëtarët e mekanizmit koordinues u pyetën se sa herë janë takuar si pjesë e mekanizmit koordinues dhe përveç anëtarëve në Dragash ku mekanizmi koordinues është krijuar kohët e fundit, shumica e të anketuarve deklaruan se ata kanë marrë pjesë disa herë duke filluar nga 1 herë deri në 7 herë.

Një pyetje ishte nëse institucioni i të anketuarit ka emëruar një person për mekanizmin koordinues dhe në 95 përqind të rasteve institucionet kanë emëruar një person dhe pesë përqind të rasteve asnjë person nuk është emëruar (Figura 2). Në mesin e përfaqësuesve të emëruar 60 përqind janë femra dhe 40 përqind meshkuj (Figura 3).

Figura 2: Nëse personi është emëruar





Figura 3: Gjinia e personit të emëruar



Më shumë se 20 përqind e të anketuarve deklaruan se ata kanë munguar në takimimin e mekanizmit koordinues (Figura 4-19 persona janë përgjegjgur) dhe arsyeja kryesore e deklaruar (në mesin e 12 të anketuarve) ishte se ata ishin të zënë. Siç mund të vërehet nga Figura 5, tetë përqind e të anketuarve u përgjigjën se ata

kanë munguar në takim pasi ata janë informuar me vonësë, gjë që tregon se ekziston një hapësirë për koordinim më të mirë të mekanizmit.

Figura 4: Nëse ka munguar në takim






Figura 5: Arsyeja e mungesës në takim



Të dhënat tregojnë se 38 përqind e të anketuarve konsiderojnë se mekanizmi koordinues është shumë i dobishëm dhe 62 përqind që është dobishëm sa i përket mbështetjes së shërbimeve më të mira për të mbijetuarit e DhF dhe në përgjithësi që trajtojnë çështjet e DhF (Figura 6). Asnjë nga të anketuarit nuk pati vërejtje dhe as nuk e përmendi si të padobishme, gjë që

konfirmon rëndësinë e mekanizmit koordinues.

Figura 6: Sa i dobishëm është mekanizmi koordinues



Në pyetjen për përfitimet që rrjedhin nga mekanizmat koordinues, përgjigjet ishin si në vijim: forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve që janë pjesë e mekanizmit; përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara për të mbijetuarit e DhF; ndarja e informacioneve për rastet, çështjet dhe problemet e DhF; koordinimi i përmirësuar i aktiviteteve të institucioneve pjesë e mekanizmit koordinues. Disa të anketuar besojnë se mekanizmi koordinues gjithashtu promovon ngritjen e vetëdijësimit në lidhje me DhF dhe rrit besimin për institucionet që janë të angazhuara në ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarit e DhF.

Sa i përket funksionimit të mekanizmave koordinues problemet kryesore të identifikuara janë: takimet jo të rregullta; koordinimi i dobët për shkak të mungesës

të një koordinatori të mekanizmit dhe mungesa e një zyre; mungesa e buxhetit për mekanizmin; dhe pjesëmarrja jo e rregullt nga anëtarët.

Duke marrë parasysh dobësitë e përmendura, të anketuarit u kërkuar të propozojnë se çfarë duhet të ndryshohet për të përmirësuar dobësitë e vërejtura dhe përgjigjet e tyre ishin si në vijim: një angazhim më i madh i anëtarëve të mekanizmi koordinues; Emërimi i një koordinatori për mekanizmin; takime më të shpeshta; alokimi financiar për mekanizmin koordinues; shpërndarja e detyrave në mesin e anëtarëve; bashkëpunimi më i madh i departamentit

brenda komunave; vendimmarrje e përbashkët për aktivitete të përbashkëta; nevojat për zhvillimin e kapaciteteve për performancë më të mirë të detyrave.

Të dhënat në tabelën 1 përshkruajnë përgjigjet lidhur me nevojat për zhvillimin e kapaciteteve për institucionet e mekanizmit koordinues. Mund të vërehet se trajnimet për përmirësimin e shërbimeve për të mbijetuarit e DhF janë nevojat më të theksuara; një pjesë e barabartë e të anketuarve theksuan trajnimet mbi ligjet dhe rregulloret lidhur me DhF dhe se si mekanizmi koordinues duhet të punojë aty ku trajnimet janë të nevojshme.

Tabela 1: Cilat janë nevojat e zhvillimit për institucionet tua?

	Numri	%
Trajnim mbi ligjet dhe rregulloret lidhur me DhF	9	45
Trajnime për përmirësimin e shërbimeve për të mbijetuarit e DhF	10	50
Trajnim mbi mënyrën e funksionimit të reagimit të koordinuar të komunitetit kundër dhunës ndaj grave / DhF (mekanizmi koordinues)	9	45
Hartimi i protokolleve / rregulloreve të brendshme / MoU për të lehtësuar punën e mekanizmit koordinues (nëse një MoU i tillë nuk ekziston)	6	30

Një tjetër pyetje e parashtruar ishte se çfarë duhet të bëjë qeveria qendrore në mënyrë që të ofrojë shërbime më të mira për të mbijetuarit e DhF dhe përgjigjet e tyre janë paraqitur në Tabelën 2. Të shtohet një linjë buxhetore për komuna për DhF është theksuar si intervenimi më i përshtatshëm nga ana e qeverisë qendrore -

80 përqind e të anketuarve kanë përmendur këtë masë. Rreth 75 përqind konsiderojnë se monitorimi i implemetimit të Ligjit mbi mbrojtjen kundër DhF është një masë e rëndësishme që qeveria qendrore mund të luajë, derisa 65 përqind deklaruan se qeveria qendrore duhet të sigurojë që

Strategjia për mbrojtje kundër DhF duhet të implemetohet plotësisht.

Tabela 2: Çfarë duhet të ndërmarrin institucionet e qeverisë qendrore për të ofruar shërbime adekuate për të mbijetuarit e DhF

	Numri	%
Të shtohet një linjë buxhetore për komunat për DhF	16	80
Të sigurojë implementimin plotë të Strategjisë për Mbrojtjen nga DhF	12	60
Të monitoroj implementimin e Ligjit për Mbrojtje kundër DhF	15	75

Përgjigja ishte se duhet të ekzistojë një ekip i specializuar që punon në rastet e DhF në nivel komunal dhe se duhet të ketë një linjë të veçantë buxhetore në nivel komunal për shërbimet për të mbijetuarit e DhF.

Problemet kryesore me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DhF

Problemet kryesore me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DhF janë: rehabilitimi; re-integrimi; strehimi; papunësia; mungesa e burimeve financiare për të mbijetuarit e DhF; mungesa e vendin të duhur në stacionin e policisë, kur të mbijetuarit e DhF intervistohen; trashëgimia e dobët e pronës nga gratë; mungesa e vendbanimit; dhe siguria për të mbijetuarit e DhF.


Njohuri mbi BPGJ

Në pyetjen se çfarë nënkuptojnë anëtarët e mekanizmi koordinues me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, përgjigjet e tyre ishin: kjo do të thotë se të dy gjinitë përfitojnë në mënyrë të barabartë nga buxheti; shumica deklaruan se BPGJ kuptohet si një linjë e veçantë në nivel qendror për çështje gjinore; një buxhet i veçantë për punësimin e grave; krijimi i fondeve në bazë të gjinisë; alokimi i buxhetit në baza gjinore; BPGJ shihet si një instrument që mundëson formulimin e politikave në mënyrë që të përmbushë nevojat e grave dhe burrave për të arritur barazi gjinore; BPGJ si analizë mbi mënyrën se si shpenzimet dhe të ardhurat ndikojnë tek gratë dhe vajzat krahasuar me burrat; vlerësimi i buxhetit dhe i të ardhurave nga perspektiva gjinore; dhe krijimi i një buxheti që promovon barazinë gjinore. Kishte dy përgjigje si "ne nuk e dimë"

Nga Figura 7 mund të vërehet se 11 përqind (2 të anketuar) kanë deklaruar se

institucioni i tyre aplikon qasjen e buxhetimit gjinor, ndërsa të tjerët janë përgjigjur negativisht. Duke ditur se buxheti gjinor nuk është aplikuar në Kosovë, dy përgjigje pozitive tregojnë se buxheti gjinor është keqkuptuar në këto dy raste.

Figura 7: A e aplikon institucioni juaj buxhetimin gjinor?



Në pyetjen pse institucionet nuk aplikojnë BPGJ, përgjigjet varionin nga ato që konsideronin mungesën e decentralizimit si një arsye; se gjykata nuk ka nevojë për buxhet të tillë dhe se nuk ekziston politikë e tillë e përcaktuar në institucionin e tyre.

Siç pritej, të gjithë të anketuarit deklaruan se nevojat e të mbijetuarëve të DhF janë prioritet për institucionet e tyre. Si janë përcaktuar këto prioritetë atë e gjejmë kryesisht përmes intervistave individuale që pasohen nga takimet në komunitet dhe metodologjia më pak e aplikuar është nëpërmjet grupeve të fokusit (Tabela 3).

Tabela 3: Çfarë metodologji aplikon institucioni juaj për të vendosur 'nevojat e të mbijetuarve të DhF si 'prioritetet të institucionit'

	Numri	%
Intervistat individuale	7	70
Grupet e fokusit	2	20
Takimet në komunitet	3	30
Numri i të anketuarve	10	100

Propozimet për përmirësime

Pyetja e fundit drejtuar anëtarëve të mekanizmit koordinues ishte për të shtuar sugjerime për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për të mbijetuarit e DhF, përmirësimin e funksionalitetit të mekanizmit koordinues dhe nevojat për

zhvillimin e kapaciteteve. Propozimet e cekura janë si në vijim

- zbatimi i funksionalitetit të mekanizmit koordinues dhe aktivizimi i tij në kuadër të komunës;

- të punohet në rehabilitimin, arsimimin, punësimin dhe re-integrimin e të mbijetuarve të DhF;
- strehimoret duhet të mbështeten financiarisht nga niveli qendror dhe lokal;
- duhet të ekzistojë një hapësirë e veçantë në stacionin e policisë për fëmijë dhe të mbijetuarit e DhF gjatë realizimit të intervistave;
- dhe të sigurohet implementimi i Ligjeve për BGJ.

10. Zhvillimet aktuale lidhur me DhF: RrGK; OSBE dhe UNDP

Siç tregohet në këtë document, ABGJ ka cekur se një zhvillim pozitiv është se ligji i ri për barazi gjinore (Ligji do të rishikohet) do të ketë një nen mbi buxhetimin gjinor. Gjithashtu u theksua nga ABGJ se të paturit e një koordinatori të emëruar për të monitoruar implemetimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit mbi Mbrojtje nga

Dhuna në Familje do të rrisë mbështetjen për të mbijetuarit e DhF.

OSBE: takim me Xhylijeta Devollin: Këshilltare Ligjore Kombëtare për Gratë dhe Fëmijët, Pika Fokale Gjinore; Departamenti i OSBE për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitetet

OSBE-ja ka organizuar trajnime me institucionet e përfshira në implementimin e Ligjit për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje. Pjesëmarrësit ishin: mbrojtësit e viktimave; zyrtarët e policisë, punonjësit socialë, zyrtarja e BGJ, strehimoret dhe OJQ-të e angazhuara në aktivitetet e lidhura me të mbijetuarit e DhF dhe mediat. OSBE-ja deri në fund të muajit nëntor do të fillojë trajnimet mbi integrimin gjinor me zyrtarët komunal për të gjitha komunat duke u fokusuar kryesisht në hartimin e politikave dhe jo në buxhetim.

Takim me Rreze Duli; pozitën nga viti 2008-2012 Menaxhere e Projektit Decentralizimi në Kosovë

Sipas Rrezë-s UNDP ka qenë e angazhuar në planet zhvillimore komunale, por nuk ka mbuluar çështjen gjinore pasi këto plane ishin nga pikëpamja ekonomike.

Trajnimet e cekura më poshtë janë siguruar nga UNDP në lidhje me buxhetimin dhe barazinë gjinore.

Në vitin 2009 UNDP organizoi Programin e Trajnimit "Ndërtimi i kapaciteteve të nëpunësve civilë të komunave të sapoformuara që përmbante 11 module ndër të cilat ka qenë Moduli i trajnimit 1 për Planifikim të Buxhetit Komunal dhe Ekzekutimi i Buxhetit brenda komunave: në veri të Mitrovicës, Graçanicë, Ranillug,

Partesh, Klllokot dhe Ministria e Pushtetit Lokal dhe Administratës. Grupi në fokus ishte: Nëpunësit Civilë, Zyrtarët e Buxhetit Komunal, Drejtorët dhe sigurisht përmbante trajnimin mbi: Planifikimin e Buxhetit; Zhvillimin e kapaciteteve për identifikimin e nevojave; planifikimin më real të buxhetit; Njohuri të procedurave ligjore në këtë proces, dhe Buxheti gjinor.

Në vitin 2010 UNDP për të gjitha komunat ka organizuar trajnimet "Të drejtat e njeriut dhe vetëdijësimi gjinor" me modulet e mëposhtme: Moduli 1: Baza fillestare për ndërtimin e një strategjie për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore; Reformat në kornizën ligjore për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore; Llegjislacioni i ri për shërbimin civil dhe për barazi gjinore; Respekti për të drejtat e njeriut në administratën publike dhe barazia gjinore; Roli dhe përgjegjësitë e Njërive Komunale për të Drejtat e Njeriut; Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; Të drejtat e minoriteteve dhe e drejta për përdorimin e gjuhës; Anti-trafikimi dhe parandali përmes mekanizmit institucional; Ligji Ndërkombëtarë për të drejtat e fëmijëve dhe legjislacioni vendor; dhe Rregullat zyrtare të shkrimit dhe raportimit për Njësitë e të Drejtave të Njeriut.

**Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK):
takim me Nicole Farnsworth; 26 korrik
2012**

RrGK ka punuar për disa kohë në fushën e DhF kryesisht në nivel makro duke intervistuar akterët kryesore me qëllim që të marrë llogaritjen e kostos për shërbimet e DhF të cilat do të përdoren për qëllime të

buxhetit. Raporti është publikuar në shtator 2012

11.

Gjetjet kryesore dhe rekomandimet

Në këtë seksion janë paraqitur gjetjet kryesore dhe propozimet mbi mënyrën për të përmirësuar shërbimet për të mbijetuarit e DhF në nivel lokal.

Gjetjet kryesore që rrjedhin nga ky hulumtim janë si në vijim:

- Edhe pse nuk ka një linjë të ndarë buxhetore për dhunën në familje në nivel komunal, shtëpitë strehuese janë përkrahur financiarisht nga komunat dhe aktivitetet që lidhen kryesisht me ditët e vetëdijësimit janë përkrahur, por e gjithë kjo mbështetje varet në mënyrë vendimtare nga vullneti i Kryetarit të Komunës dhe kuptohet se komuna përballlet me kufizime financiare;
- Zyrtarja/i për barazi gjinore në nivel lokal nuk ka linjë buxhetore prandaj ekzistojnë vështirësitë për të mbështetur aktivitetet. Është kuptuar puna që bëhet për aktivitetet e lidhura me DhF varet shumë nga angazhimi i zyrtarit për BGJ, gjë e cila u konfirmua gjithashtu nga ABGJ;

- Duke pasur parasysh se Zyrtari/ja për BGJ është nën Njësine për të Drejtat e Njeriut dhe nuk ka linjë buxhetore, zyrtari për BGJ nuk angazhohet në përgatitjen e buxhetit. Mungesa e linjës së veçantë buxhetore demotivon Zyrtarët për BGJ për të përgatitur plane pune për çështjet gjinore. Për më tepër ata të marrin pjesë në dëgjimin publik për buxhetin vetëm si vëzhgues dmth prania e tyre nuk është e detyrueshme;
- Përsa i përket dëgjimeve publike është vërejtur se kryesisht paraqiten projektet për investime kapitale. Në shumicën e rasteve, pjesëmarrja e grave është pothuajse jo e pranishme dhe asnjë OJQ nuk merr pjesë në dëgjimet publike, ku mund të dëgjohet zëri i tyre;
- Ekziston mungesa e informacionit dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet Shefit të Financave dhe zyrtarit për BGJ- janë dhënë deklarata të ndryshme;
- Strehimoret, si një nga ofruesit kryesorë të shërbimeve në rrethin përmes të cilit të mbijetuarit e DhF shkojnë, kanë si problemin kryesor qëndrueshmërinë financiare. MPMS dhe donatorët kanë qenë burimi kryesor i financimit me pak mbështetje të ofruar herë pas here nga komunat;
- Siç tregohet nga hulumtimi i mëparshëm, re-integrimi i të mbijetuarve të DhF mbetet sfida më e madhe, duke përfshirë sigurimin e strehimit të përhershëm dhe punësimin e tyre;
- Janë bërë ankesa lidhur me implementimin e Ligjit domethënë fakti që të mbijetuarit e DhF largohen nga shtëpia ku ushtrohet dhuna dhe jo siç është caktuar nga ligji se ajo duhet të qëndrojë në shtëpi;
- Komunat përballen me kufizime financiare dhe janë në nevojë urgjente për të pasur një grant të veçantë për shërbimet sociale nëse këto shërbime inkurajohen;
- Decentralizimi i shërbimeve sociale konsiderohet se ka krijuar një situatë të vështirë për komunat pasi kjo nuk shoqërohet me decentralizimin financiar;
- Ekziston hapësirë për intervenim për të përmirësuar njohuritë mbi strategjitë dhe dokumentet tjera relevante për DhF;
- Pjesëmarrja në takimet e mekanizmave koordinues ndryshon dhe rreth një e pesta ka deklaruar se kanë munguar në një takim dhe se kryesisht pasi ata ishin të zënë;
- Mekanizmi Koordinues konsiderohet se duhet të përmirësojë shërbimet e ofruara për të mbijetuarit e DhF dhe aktivitetet e koordinimit midis institucioneve anëtare janë përmendur si përfitimi kryesor që buron nga mekanizmi;
- Mungesa e anëtarëve në takime; mungesa e një koordinatori dhe mungesa e buxhetit janë problemet më të cituara me të cilat përballen mekanizmat koordinues;
- Në përgjithësi ekziston keqkuptim në lidhje me BPGJ që konsiderohet kryesisht si ekzistimi i buxhetit të veçantë për burrat dhe gratë;
- Asnjë nga institucionet e intervistuar nuk aplikojnë BPGJ-në në procesin e tyre buxhetor;

Rekomandimet

Intervenimet në nivel komunal

- Duhet të realizohet monitorim i afërt për implementimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje kundër Dhunës në Familje;
- Komunat duhet të kenë një zyrë pra një linjë të veçantë buxhetore e cila do të përdoret edhe për aktivitetet që lidhen me DhF. Përndryshe një 'linjë buxhetore' për DhF mund të shtohet si pjesë e zyrës së kryetarit të komunës;
- Një buxhet i qëndrueshëm është i nevojshëm të sigurohet për strehimore edhe pse kjo mund të bie kryesisht si pjesë e MPMS-së;
- Një buxhet i qëndrueshëm është i nevojshëm për t'u siguruar për strehimore edhe pse kjo mund të bien kryesisht si pjesë e MPMS-së;
- Qasja me pjesëmarrje në përgatitjen e buxhetit duhet të rritet. Zyrtari për BGJ nuk duhet të jetë vetëm i pranishëm, por edhe të punojë në sigurimin e pjesëmarrjes së grave dhe OJQ-ve dhe paraprkishtë të diskutojë mbi nevojat lidhur me DhF dhe të tjerët;
- Angazhimi duhet të bëhet për t'u përfshirë në dëgjimet publike për buxhetin gjithashtu për buxheti për shërbime sociale dmth buxheti për shërbimet e lidhura me DhF (edhe pse nuk ka linjë të veçantë buxhetore, por të paktën duhet theksuar se linja e tillë nuk ekziston, por që në kuadër të zyrës së kryetarit të komunës do të ketë disa alokime);
- Duke pasur parasysh se sigurimi i strehimit të përhershëm është një pengesë e madhe, lobimi mund të bëhet në nivel komunal në mënyrë që kur aplikacionet për strehim social të shqyrtohen prioritet t'i jepet të mbijetuarve të DhF;
- Fondet e komunës mund të përdoren për qëllime të re-integrimit kryesisht për arsim dhe punësim. Aktualisht në Kosovë ka projekte të drejtuara lidhur me bizneset e reja dhe të mbijetuarit e DhF mund të angazhohen në këto projekte të cilat do të luajnë dy role- trajnime dhe potencialin për t'u bërë i pavarur. Këto mund të ndiqen nga Zyrtarët për BGJ dhe të kalohen tek ata që janë përgjegjës për projekte të tilla;
- Për të mbijetuarit e DhF mund të sigurohet puna nga bashkëpunimi i ngushtë me Qendrat e Punësimit;
- Decentralizimi duhet të bëhet më efikas që të lejojë komunat të planifikojnë buxhetin, duke përdorur të dhënat e fundit mbi nevojat lidhur me shërbimet sociale për të mbijetuarit e DhF;
- Emërimi i një koordinatori për mekanizmin koordinues dhe zhvillimi i procedurave të raportimit për t'u siguruar që takimet të mbahen rregullisht dhe përfitimet të burojnë nga mekanizmi;
- Alokimi i buxhetit për funksionimin e mekanizmit;
- Përgjegjësi më e madhe kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në mbledhje nga të gjithë anëtarët;
- Të zhvillohen më shumë takime të rregullta gjë që konfirmon nevojën për emërimin e koordinatorit;

Nevojat për zhvillimin e kapaciteteve për pjesëtarët e mekanizmit koordinues

- Trajnimet për Zyrtarët për BGJ e nevojshme për t'i bërë ata më kërkuar dhe të ngrenë zërin e tyre në nivel komunal;
- Zyrtarët për BGJ duhet të jenë më kritik dhe të mos raportojnë gjendje më të mirë se sa është. Mund të organizohen trajnime mbi mënyrën se si ata duhet të raportojnë dhe mbledhin informata gjithashtu lidhur me DhF pasi që nuk ka pasur

raporte në dispozicion e cila nga ana tjetër do ta bëjë të vështirë që Zyrtarët për BGJ të llojnë për interesat e të mbijetuarve të DhF;

- Trajnime lidhur me Ligjet dhe dokumentet lidhur me DhF;
- Ekziston nevoja për trajnim mbi BPGJ për të gjitha institucionet e përfshira në studim;
- Trajnime për funksionimin e mekanizmit koordinues dhe për hartimin e protokolleve dhe rregulloreve të mekanizmit koordinues.

Referencat

Rames, V., 2012, Hartimi i Shërbimeve Sociale në 3 komunat për Programin e Përbashkët të UNKT mbi Dhunën në Familje në Kosovë

KIPRED, 2011, Fondet publike: Drejt një menaxhimi efikas dhe transparent të buxhetit komunal

RrGK 2008, Hulumtim kërkimor mbi Nivelin e Dhunës në Baza Gjimore në Kosovë dhe ndikimi i tij në Shëndetin Riprodhues të Grave

Shtojcë: Pyetësori

Gusht 2012

Pyetësor lidhur me funksionalitetin e mekanizmit koordinues lidhur me DhF dhe nevojat e zhvillimit të institucioneve të përfshira në mekanizmin, në komunën e Dragashit, Gjakovës dhe Gjilanit

Qëllimi i këtij pyetësori është mbledhja e informacioneve në lidhje me funksionimin e mekanizmit koordinues të përbërë nga institucionet që ofrojnë shërbime për të mbijetuarit e dhunës në familje dhe gjithashtu për të identifikuar nevojat e zhvillimit të këtyre institucioneve duke përfshirë temën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si një koncept i ri që prodhon ndikim të dobishëm në shoqëritë demokratike që promovojnë barazinë gjinore. Të dhënat do të analizohen dhe përfshihen në një raport i cili do të shërbejë si bazë për të hartuar trajnime dhe aktivitete të tjera me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të ofruar për të mbijetuarit e dhunës në familje në Kosovë.

Pyetësori është anonim dhe intervista do të bëhet nga koordinаторët e UNKT dhe sipas nevojës një konsulent i angazhuar nga UN WOMEN do të zhvillojë intervistat.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

Pyetësori

1. Institucioni:
2. Pozita:
3. Gjinia: 1. Femër 2. Mashkull
4. Moshë:

5. Ju lutemi shënoni ligjin dhe rregulloret që caktojnë detyrat tuaja (siç u përmend më lart).

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.

I. Niveli i njohurive mbi Ligjet dhe dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare me rëndësi për barazinë gjinore.

6. A mund të emëroni Ligjet kombëtare, strategjitë dhe planet që mbështesin / promovojnë barazinë gjinore në Kosovë.

7. A keni njohuri mbi Ligjin e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje?

1. Po 2. Jo

8. A mund të emëroni dokumentet ndërkombëtare lidhur me barazinë gjinore të cilat janë bazë për ligjet kombëtare.

9. A keni marrë ndonjëherë trajnim në punë në lidhje me standardet / rregulloret themelore të punës lidhur me rastet e dhunës në familje?

1. Po
2. Jo

10.1 Nëse Po, cilat institucione / organizata kanë ofruar trajnime dhe kur?

Institucioni

Viti

II. Roli dhe niveli i aktiviteteve nga mekanizmi dhe nevojat e zhvillimit të kapaciteteve

10. Kur është bërë institucioni juaj anëtare e mekanizmit koordinues (ju lutem shënoni muajin dhe vitin):

11. A ka emëruar institucioni juaj një person për të marrë pjesë në takimet e mekanizmit koordinues?

- Po
- Jo
- Nuk kam njohuri

11.1 Nëse po, ju lutem tregoni pozitën e tij / saj në institucion dhe gjininë tij / saj

12. Sa herë keni marrë pjesë në takimin e mekanizmit koordinues?
_____ herë

13. A keni munguar në ndonjë takim:

1. Po
2. Jo

15a. Nëse keni munguar në një takim cila ishte arsyeja?

1. Zënë në punë
2. Jam informuar me vonësë
3. Arsye të tjera (ju lutemi specifikoni)

14. Sa të dobishme e shihni ekzistencën e mekanizmit koordinues?

1. Shumë të dobishme
2. Të dobishme
3. Pak a shumë të dobishme
4. Të padobishme

15. A mund të emëroni tre përfitimet kryesore që dalin nga mekanizmi koordinues?

- 1.
- 2.
- 3.

16. A mund të emëroni tre dobësitë kryesore në mbarëvajtjen e mekanizmit deri më tani?

- 1.
- 2.
- 3.

17. Çfarë duhet të ndryshohet që mekanizmi koordinues të punojë në mënyrë efikase, nëse ka nevojë?

- 1.
- 2.
- 3.

18. Cilat janë nevojat e zhvillimit të institucionit tuaj lidhur me DhF si pjesë e mekanizmit koordinues?

1. Trajnime mbi ligjet dhe rregulloren
2. Trajnime në përmirësimin e shërbimeve për të mbijetuarit e DhF
3. Trajnime për mënyrën e funksionimit të përgjigjes së koordinuar të komunitetit kundër dhunës ndaj grave / DhF (mekanizmi koordinues)
4. Hartimi i protokolleve të brendshme / rregulloreve / MoU për të lehtësuar punën e mekanizmit koordinues (nëse nuk ekziston një MoU i tillë)
5. Mbështetje shtesë për përmirësimin e funksionimit të mekanizmit koordinues (ju lutem specifikoni)

19. Cilat mendoni se janë tre çështjet / problemet më të mëdha të mbijetuarve të DhF lidhur me fushën tuaj të punës?

- 1.
- 2.
- 3.

20. Nëse ka çështje që duhet të trajtohen si mund të zgjidhen ato?

21. Çfarë mendoni se duhet të bëjnë institucionet qendrore qeveritare (dmth Ministria përkatëse) për të siguruar që të mbijetuarit e DhF të marrin shërbime më të përshtatshme në nivel lokal?

1. Të shtohet një linjë buxhetore për komunat për DhF
2. Të sigurohet implementimi i plotë i strategjisë për Mbrojtje kundër DhF
3. Të monitorohet implementimi i Ligjit për Mbrojtje kundër DhF
4. Të tjera (ju lutem specifikoni)

III. Niveli i njohurive mbi BPGJ

22. Çfarë nënkuptoni me BPGJ?

23. A e përdorni BPGJ-në si një mjet planifikimi në institucionin tuaj?

1. Po;
2. Jo;
3. Nuk e di

23.1 Nëse PO, a mund të përshkruani si e përdorni atë (për çfarë qëllimesh dhe kur saktësisht)?

23.2 Nëse jo, pse mendoni se institucioni juaj nuk e përdor BPGJ-në?

24. Komuna në të cilën ju veproni, a e bën ndarjen e buxhetit për mbështetje për të mbijetuarit e DhF?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di

24.1 Nëse Po, a keni njohuri se cila është % e këtij buxheti në buxhetin total të komunës për një vit?

25. A I jep prioritet institucioni juaj nevojave të mbijetuarve të DhF?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di

25.1 Nëse PO, si realizohet kjo, ju lutem tregoni metodologjinë e përdorur

1. Intervistat individuale
2. Grupet e fokusit
3. Takimet në komunitet
4. Të tjera? (ju lutem specifikoni)

IV. Komentet dhe propozimet

1. Ju lutem shtoni ndonjë koment dhe propozime

Data e intervistës:

**Raporti Përfundimtar: Alokimi i buxhetit për shërbimet e DhF në nivel komunal;
funksionalizimi i mekanizmave koordinues dhe njohuritë mbi Buxhetimin e Përgjithshëm
Gjinor/Qershor 2015**

Shkurtesat.....	50
1. Hyrje dhe qasja në metodologji	51
2. Zhvillimet që nga viti 2012 dhe mbështetja e dhënë nga komunat: Gjetjet nga diskutimet në grupet e fokusit.....	53
2.1 Zhvillimet kryesore dhe mbështetja e dhënë nga komunat	53
2.2 Funksionimi i mekanizmave koordinues.....	55
2.3 Aktivitetet e organizuara / mbështetura nga mekanizmat koordinues	57
2.4 Qëndrueshmëria e mekanizmave koordinues: sfidat dhe mundësitë	58
3. Gjetjet nga sondazhi me anëtarët e mekanizmit koordinues.....	59
3.1 Njohuri për ligjet lidhur me gjininë, strategjitë dhe dokumentet, me fokus në dhunën në familje mbi baza gjinore.....	59
3.2 Mbështetja e nevojshme në nivel qendror dhe lokal	64
3.3 Problemet kryesore me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DhF	65
3.4 Njohuri mbi BPGJ	66
3.5 Zhvillimet në nivel qendror dhe lokal që nga viti 2012	67
4. Përfundime dhe rekomandime	68
Shtojca 1: Pyetësi.....	71
Pyetësi.....	72

Shkurtesat

CEDAW	Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
QPS	Qendrat për punë sociale
DhF	Dhuna në Familje
BPGJ	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinnor
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizatat Joqeveritare
PSO	Procedurat Standarde të Operimit

1.

Hyrje dhe qasja në metodologji

Në vitin 2012 UN Women ka përkrahur zhvillimin e një studimi në lidhje me tri çështje mbi gjendjen në nivel komunal komunitat e Dragashit, Gjakovës dhe Gjilanit sigurojnë mbështetje financiare për shërbimet për të mbijetuarit e DhF; për të kuptuar funksionimin e mekanizmit koordinues (një mekanizëm që përfshin përfaqësues nga të gjitha institucionet që janë të angazhuar në ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarit e DhF) dhe nevojat e tyre të zhvillimit për të ofruar shërbime më të përshtatshme për të mbijetuarit e DhF; dhe për të mbledhur informacion mbi njohuritë që anëtarët e mekanizmit koordinues kanë për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe nëse institucionet e tyre aplikojnë këtë procedurë të buxhetimit.

Bazuar në hulumtimin e të dhënave, intervistave dhe sondazhit, të gjeturat

kryesore nga studimi ishin si në vijim: asnjë prej komunave nuk kanë një linjë të veçantë buxhetore për dhunën në familje, por komunitat sigurojnë përkrahje financiare për shërbimin e DhF: kjo ndodh sepse komunitat përballen me kufizime financiare dhe janë në nevojë urgjente për të pasur një grant të veçantë për shërbimet sociale nëse dëshirojnë nxitjen e këtyre shërbimeve; zyrtarja për Barazi Gjinore në nivel lokal nuk ka linjë buxhetore prandaj shfaqen vështirësi për të mbështetur aktivitetet; shtëpitë strehuese përballen me kufizime financiare dhe qëndrueshmëria e tyre është në rrezik (MPMS dhe donatorët kanë qenë burimi kryesor i financimit me pak mbështetje të ofruar herë pas here nga komunitat); re-integrimi i të mbijetuarve të DhF mbetet sfida më e madhe, duke përfshirë sigurimin e strehimit të përhershëm dhe punësimit të tyre; është identifikuar nevoja për përmirësimin e njohurive mbi strategjitë dhe dokumentet tjera relevante për DhF);. Përsa i përket funksionimit të mekanizmit koordinues është bërë një marrëveshje e përgjithshme se mekanizmi është i nevojshëm, por pjesëmarrja nuk ishte në nivel të dëshiruar; mungesa e një koordinatori dhe mungesa e buxhetit janë problemet më të cituara me të cilat mekanizmat koordinues janë

ballafaquar. Në fund lidhur me njohuritë mbi BPGJ është zbuluar se ka ekzistuar një keqkuptim në lidhje me BPGJ pasi kryesisht është kuptuar se ekzistojnë buxhete të ndara për burrat dhe gratë; në fund është kuptuar se asnjë nga institucionet e intervistuar nuk aplikojnë BPGJ në procesin e tyre të buxhetimit.

Duke u bazuar në gjetjet nga hulumtimi janë propozuar rekomandimet kryesore si në vijim: komunat duhet të kenë një zyrë rrjedhimisht një linjë të veçantë buxhetore e cila do të përdoret edhe për aktivitete lidhur me DhF; një buxhet i qëndrueshëm është i nevojshëm që të sigurohet për strehimoret edhe pse kjo mund të bie kryesisht si pjesë e MPMS-së; të sigurohet ofrimi i strehimit social/apartamenteve për të mbijetuarit e DhF; më shumë mbështetje për re-integrimin e të mbijetuarve të DhF përmes ngritjes së aftësive dhe punësimit; emërimi i një koordinatori për mekanizmin koordinues dhe zhvillimi i procedurave të raportimit për të siguruar mbajtjen e rregullt të takimeve dhe burimin e përfitimeve nga mekanizmi; alokimin e buxhetit për funksionimin e mekanizmit; më shumë takime të rregullta të mekanizmave koordinues dhe përgjegjësi më e madhe kur bëhet fjalë për frekuentimin e takimeve nga të gjithë anëtarët. Një propozim i rëndësishëm ishte nevojshmëria për

nevojat e zhvillimit të kapaciteteve për anëtarët e mekanizmave koordinues përmes trajnimeve lidhur me Ligjet dhe dokumentet lidhur me DhF, trajnime në fushën e BPGJ dhe trajnime të tjera që do të rrisin funksionimin e mekanizmave të koordinues.

Pas mbledhjes së informacioneve për studimin bazë ky studim synon të analizojë progresin e bërë që nga viti 2012 në tri komuna. Për të mbledhur informacionin e nevojshëm janë organizuar diskutime në grupin e fokusit me mekanizmat koordinues në tri komuna dhe gjithashtu u realizua një sondazh edhe me anëtarët e mekanizmave koordinues. Në Gjilan Kryetari i Komunës ishte i pranishëm në fillim të takimit dhe në Gjakovë këshilltari i Kryetarit ishte i pranishëm në mbledhje dhe në mënyrë aktive dhe konstruktive ka marrë pjesë në diskutime. Diskutimet e grupit të fokusit ishin të fokusuara në adresimin e pyetjeve të mëposhtme: cili ka qenë progresi në funksionimin e mekanizmave koordinues që nga viti 2012, çfarë aktiviteteve janë ndërmarrë, roli i koordinatorëve të caktuar, çështja e qëndrueshmërisë së mekanizmave koordinues dhe mbështetja e ofruar aktualisht nga komunat dhe planet e ardhshme, çfarë përfitime ofron mekanizmi koordinues për të mbijetuarit e DhF, sfidat kryesore me të cilat

ballafaqohen të mbijetuarit e DhFn dhe si duhet të trajtohen ato.

Për të kuptuar progresin e arritur që nga viti 2012 është aplikuar një pyetësor pothuajse I njëjtë për sondazhin me anëtarët e mekanizmit koordinues. Vetëm një seksion u shtua me pyetje të drejtpërdrejta mbi funksionimin e mekanizmit koordinues dhe nëse janë bërë zhvillime në nivel qendror për të mbështetur të mbijetuarit e DhF.

Raporti përbëhet nga pjesët e mëposhtme: Kapitulli 2 diskuton gjetjet nga diskutimet e grupeve të fokusit me mekanizmat koordinues në tri komuna. Gjetjet nga sondazhi janë elaboruar në Kapitullin 3. Në kapitullin 3 janë ofruar analiza krahasuese mes dy raundeve të sondazhit. Raporti përfundon me gjetjet kryesore dhe propozimet për përmirësim të mëtejshëm në funksionimin dhe qëndrueshmërinë e mekanizmave koordinues, për të siguruar mbështetje të mjaftueshme financiare nga komunat për të mbështetur të mbijetuarit e DhF dhe gjithashtu për të ofruar shërbime adekuate dhe të nevojshme për të mbijetuarit e DhF, jo vetëm për të garantuar sigurinë e tyre por edhe ri-integrimin e tyre në radhë të parë duke lehtësuar mundësitë e tyre të punësimit.

2.

Zhvillimet që nga viti 2012 dhe mbështetja e dhënë nga komunat: Gjetjet nga diskutimet në grupet e fokusit

2.1 Zhvillimet kryesore dhe mbështetja e dhënë nga komunat

Zhvillimet kryesore dhe mbështetja e dhënë nga komunat që nga viti 2012 janë si më poshtë:

- Janë zhvilluar strategjitë komunale për mbrojtje kundër DhF, shoqëruar nga Planet e Veprimit për mbrojtje kundër DhF dhe Kostoja për secilin aktivitet. Kjo ka

shërbyer edhe si ushtrim për zhvillimin e kapaciteteve për të gjithë anëtarët pjesëmarrës;

- Është forcuar bashkëpunimi midis mekanizmave koordinues, duke përfshirë OSHC-të dhe zyrtarët e sapo zgjedhur komunal dhe nevojat për të mbijetuarit e DhF janë paraqitur në mënyrë të qartë tek autoritetet e nivelit lokal. Si rezultat Kryetarët në tre komuna kanë ndarë fonde për implementimin e propozimeve të përbashkëta të projektit, ndërsa UN Women ka ofruar më pak se 30% për të mbështetur propozimet.
- Në tre qytete "dhomat miqësore të intervistimit" në stacionet e policisë janë pajisur dhe janë përdorur për Viktimat e dhunës dhe fëmijët e tyre. Me përkrahje nga UN WOMEN disa zyrtarë të policisë janë trajnuar në Britani të Madhe që është deklaruar se ka qenë shumë e dobishme për punën e tyre;
- Të tre komunat kanë ndarë një shumë të caktuar të buxhetit në mbështetjen e veprimtarive gjatë 16 ditëve të aktivizmit dhe ditëve të ngjashme të avokimit;
- Strehimore sociale për të mbijetuarit e DhF janë siguruar nga

komuna e Gjakovës dhe Gjiçanit dhe është premtuar mbështetja e mëtejshme. Për më tepër, në komunën e Gjakovës është shtuar një kriter shtesë për strehim social sipas të cilit viktimat e dhunës janë mes grupeve prioritare që do të konsiderohen;

- Është arritur marrëveshja ndërmjet Komisionit Komunal për Strehim dhe Shtëpisë së Sigurtë për objektet sociale për rastet e DhF në Gjakovë.
- Kryetarja e komunës së Gjakovës ka shfaqur përkushtim për të ndarë një buxhet të veçantë I cili do të alokohet për funksionimin e mekanizmit koordinues në vitin 2016;
- Fëmijët e të mbijetuarve të DhF nuk paguajnë asnjë kosto për qëndrimin e tyre ditor në institucionet parashkollore;
- Është arritur dhe implementuar marrëveshja ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe Njesisë për DhF të Policisë së Kosovës për alokimin e buxhetit për të mbuluar nevojat themelore për të mbijetuarit e DhF gjatë qëndrimit të tyre në stacionin e Policisë;
- UN Women ka mbështetur OSHC-të që merren me çështjet e DhF në

zhvillimin e projekt propozimeve për avokimin dhe iniciativat e BPGJ dhe I paraqesin ato tek autoritetet lokale komunale;

- Është ofruar trajnim mbi implementimin e SOP nga Agjencia për Barazi Gjinore dhe Policia për të gjithë anëtarët e mekanizmave koordinues në 3 komunitat;
- Bazuar në përvojën e fituar në të 3 pilot komunitat, është krijuar manuali I BPGJ dhe është i gatshëm të përdoret kur të zhvillohen iniciativa të ngjashme;
- Anëtarët e mekanizmave koordinues, duke përfshirë OSHC-të janë mire të informuar mbi qasjen dhe e mbështesin nevojën për implementimin e BPGJ në institucionet e tyre dhe tek autoritetet vendore, edhe pse nevojitet punë e mëtejshme në drejtim të avokimit për BPGJ; dhe
- Në qershor të vitit 2015 UN Women ka organizuar një trajnim me anëtarët e mekanizmit koordinues për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor me fokus të veçantë në planifikimin e aktiviteteve konkrete për mbështetje të mbijetuarve të DhF, duke identifikuar gjithashtu një

linjë buxhetore nga e cila mund të ndahet mbështetja për aktivitetet e planifikuara;

- UN Women ka furnizuar mekanizmat koordinues me laptopë, projektorë, printerë gjë e cila ka lehtësuar koordinimin, komunikimin dhe ka mbështetur implementimin e aktiviteteve.

Në fund duhet theksuar se zyrtarët për barazi gjinore nuk kanë ndonjë buxhet për ndërmarrjen e aktiviteteve.

2.2 Funksionimi i mekanizmave koordinues

Nga diskutimet me anëtarët e mekanizmave koordinues është arritur në përfundimin se që nga viti 2012 mekanizmat koordinues kanë qenë më funksional. Në Gjakovë mekanizmat përbëhen nga 20 anëtarë, në Gjilan 18 dhe në Dragash mekanizmi përbëhet nga 13 anëtarë. Në Dragash nuk ka strehimore, por ajo në Prizren mbulon zonën e Dragashit gjithashtu. Funksionaliteti për anëtarët nënkupton mbajtjen e takimeve të rregullta, ekziston pjesëmarrja e rregullt e të gjithë anëtarëve dhe bashkëpunimi është përmirësuar në masë të madhe në mesin e

anëtarëve. Përfitimet kryesore nga mekanizmat koordinues janë si më poshtë: vendimmarrje e përbashkët për raste të caktuara të DhF; menaxhim më efikas i rasteve; ngritje e vetëdijësimit të komunitetit mbi DhF; mbështetja e re-integrimit të mbijetuarve të DhF; shërbime më të mira për të mbijetuarit e DhF dhe gjithashtu të dhëna të sakta për DhF. Anëtarët e mekanizmit koordinues ishin të angazhuar ngushtë në organizimin e 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës në Familje mbi Baza Gjinore.

Në studimin bazë propozimi ishte që të caktohet një koordinator për mekanizmat në secilën komunë pasi kjo do të mundësonte funksionimin më të mirë të mekanizmave. Tani, i gjithë koordinimi, në tre komunat është caktuar një koordinator për mekanizmin koordinues: në komunën e Dragashit dhe Gjakovës ky rol luhet nga zyrtarët për barazi gjinore dhe në Gjiçan është angazhuar një staf i ri për këtë pozitë (paguhen bashkërisht nga UNWOMEN dhe komuna)

Sipas anëtarëve të mekanizmave tani rastet trajtohen më shpejtë dhe në mënyrë më të përshtatshme. Anëtarët e mekanizmave koordinues komunikojnë drejtpërdrejt me njëri-tjetrin duke siguruar që shërbimet të dorëzohen në kohë dhe të cilësisë më të mirë të mundshme. Rastet individuale që e konfirmojnë këtë konstatim janë paraqitur.

Mesatarisht mekanizmat koordinues takohen 6 herë në vit (çdo dy muaj) dhe kur është e nevojshme zhvillohen takime plotësuese. Në çdo takim anëtarë nga të gjitha institucionet raportojnë për numrin e rasteve të DhF dhe shërbimet e ofruara. Mekanizmat koordinues shërbejnë si një platformë për diskutimin e problemeve, sfidave dhe mënyrave për trajtimin më të mirë të atyre sfidave. Për shembull, re-integrimi i të mbijetuarve të DhF është identifikuar si një nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DhF. Kjo temë është diskutuar në mekanizmin koordinues dhe përfaqësuesi i Zyrës së Punësimit ka këshilluar punonjësit nga qendrat për Punë Sociale që të informojnë anëtarët mbi politikat aktive të tregut të punës të ofruar nga Zyrat e Punës dhe gjithashtu parakushtet për qasje në këto shërbime. Si rezultat, tani të mbijetuarit e DhF këshillohen dhe mbështetën në regjistrimin e tyre si të papunë në Zyrat e Punësimit dhe kanë qasje në shërbimet e ndërmjetësimit për trajnime dhe punësim. Disa raste të suksesshme të punësimit (në Gjiçan 12 të mbijetuar të DhF janë punësuar përmes skemës së trajnimit të implementuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) dhe raste të trajnimit janë theksuar gjatë diskutimeve, por ka një hapësirë për angazhim të mëtejshëm në lehtësimin e punësimit për të mbijetuarit e DhF. Shtëpitë strehuese duhet të

bashkëpunojnë ngushtë me Zyrat e Punësimi në identifikimin e projekteve që do të përputhen me aftësitë dhe nevojat e të mbijetuarve të DhF.

Për ngritjen e vetëdijësimi dhe gjithashtu për arritjen e të mbijetuarve të DhF, mekanizmat koordinues kanë hapur një llogari të rrjetit social, i cili siç pohohet, ka mbështetur informacionet mbi rolin e mekanizmit dhe shërbimeve në dispozicion për të mbijetuarit e DhF.

2.3 Aktivitetet e organizuara / mbështetura nga mekanizmat koordinues

Zhvillimi kryesor ka qenë nënshkrimi i MoU midis të gjithë anëtarëve të mekanizmit koordinues duke përfshirë edhe komunat. Në tri komuna gjatë seminareve mekanizmat koordinues kanë zhvilluar strategji për parandalimin e DhF, mbrojtjen dhe mbështetjen për të mbijetuarit e DhF, që mbulon periudhën 2013-2016. Si shtesë, janë zhvilluar planet e veprimit për implementimin e strategjive. Megjithatë, deri më tani implementimi i strategjive ka qenë i limituar për shkak të mungesës së burimeve financiare. Gjithashtu është gjetur se nuk ka

monitorim të duhur dhe raportim për implementimin e strategjisë si për mekanizmin koordinues ashtu dhe për komunën. Në vijim paraqitet një përshkrim i shkurtër i strategjive.

Strategjia Lokale kundër DhF për komunën e Gjakovës ka për qëllim të:

- ✓ Punojë për parandalimin e dhunës në familje dhe ngritjen e vetëdijësimi të komunitetit për aspektet negative të këtij fenomeni;
- ✓ Të përmirësojë / ndërtojë sistemin për grumbullimin dhe ndarjen e të dhënave në mes të anëtarëve të Mekanizmit;
- ✓ Të fuqizojë mekanizmat për reagim më të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojë koordinimin në mes të anëtarëve të mekanizmit; dhe
- ✓ Të sigurojë avokimin dhe monitorimin e implementimit të politikave dhe të sugjerojë ndryshime të bazuara në praktikat më të mira në fushën e DhF.

Strategjia Lokale kundër DhF për komunën e Gjilanit ka për qëllim të:

- ✓ Të sigurojë koordinim funksional dhe të mirë ndërmjet institucioneve për parandalimin dhe mbrojtjen e

viktimave dhe familjeve të dhunës në familje dhe riintegrim në jetën sociale dhe ekonomike të komunës;

- ✓ Të punojë në thyerjen e stereotipeve, mentaliteteve dhe traditave që mbështesin dhe nxisin dhunën në familje, si dhe promovimin e mbrojtjes sociale për viktimat e kësaj dhune nga ana e komunitetit dhe shoqërisë në Gjiilan;
- ✓ Të sigurojë mbështetje ekonomike dhe të ofrojë mundësi për mirëqenien e të mbijetuarve të dhunës në familje dhe familjeve të tyre.

Strategjia Lokale kundër DhF për komunën e Dragashit ka për qëllim të:

- ✓ Të punojë në parandalimin e DhF, që është përcaktuar si parimi kryesor i strategjisë.
- ✓ Të sigurojë mbrojtjen e të mbijetuarve të DhF, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve institucionale, ligjore dhe sociale.
- ✓ Të lehtësojë re-integrimin e të mbijetuarve të DhF përmes edukimit të mëtejshëm, trajnimit dhe punësimit.
- ✓ Të punojë në rehabilitimin e kryerësve të dhunës në familje dhe shkelësve deri në integrimin e tyre të plotë në jetën normale.

Gjatë vitit 2012-2015 janë organizuar trajnimet e policëve, gjykatësve, prokurorëve dhe OJQ-ve mbi Ligjin për mbrojtje kundër DhF. Trajnime për Buxhetimin e Bazuar Gjinor janë organizuar gjithashtu për zyrtarët komunal dhe OJQ-të. Aktivitete janë organizuar edhe në shkolla me qëllim për të ngritur vetëdijësimin dhe në këtë mënyrë të mundësohet parandalimi i DhF. UNFPA ka organizuar trajnime për punonjësit e shëndetësisë me fokus në dhunën mbi baza gjinore. Një punonjëse shëndetësore - anëtare e mekanizmit koordinues theksoi se trajnimi i punonjësve të shëndetësisë për dhunën në familje është shumë i rëndësishëm në identifikimin e rasteve të dhunës në familje. Ajo përmendi disa raste që janë identifikuar edhe përmes fëmijëve të nënave që kanë qenë subjekt i dhunës në familje.

2.4 Qëndrueshmëria e mekanizmave koordinues: sfidat dhe mundësitë

Ekziston vullneti i fortë dhe përkushtimi i të gjithë anëtarëve të mekanizmave koordinues në mbështetjen e qëndrueshmërisë së mekanizmit. Në

përgjithësi anëtarët e mekanizmave koordinues konsiderojnë se mekanizmi është i qëndrueshëm, edhe pse një nga koordinatorët ishte skeptik për këtë, por nuk mbështetet me argumente. Zyrtarët për barazi gjinore të cilët luajnë rolin e koordinatorëve pohuan se përshkrimin i tyre i punës duhet të ndryshohet dhe ky rol shtesë duhet të përfshihet. Kjo do të lehtësojë punën e tyre dhe gjithashtu t'i bëjë ata më të përgjegjshëm. Përkrahja nga komuna është theksuar si me rëndësi qendrore për qëndrueshmërinë e mekanizmave. Mbështetja financiare u theksua si një parakusht për të prodhuar përfitime nga mekanizmat pasi kjo do të mundësojë organizimin e aktiviteteve. Këto aktivitete do të rezultojnë në parandalimin e DhF, ngritjen e vetëdijësimit dhe shërbime më të mira dhe mbështetje për të mbijetuarit e DhF. Nga diskutimet u bë e qartë se motivimi dhe përkushtimi i koordinatorëve është e një rëndësie të madhe dhe prandaj zhvillimi i tyre i kapaciteteve është i nevojshëm edhe më tej.

3. Gjetjet nga sondazhi me anëtarët e

mekanizmit koordinues

Në tre komuna 38 pyetësorë u plotësuan nga anëtarët e mekanizmit koordinues, prej të cilëve 20 ishin femra dhe 18 ishin meshkuj. Moshë mesatare e anëtarëve ishte 46 (33 prej tyre raportuan moshën e tyre).

3.1 Njohuri për ligjet lidhur me gjininë, strategjitë dhe dokumentet, me fokus në dhunën në familje mbi baza gjinore


Përveç dy anëtarëve që nuk theksuan ndonjë nga ligjet, të gjithë anëtarët e tjerë treguar njohuri për Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Për sa i përket njohurive mbi Strategjitë, të gjithë anëtarët listuan së pari Strategjinë Komunale Kundër Dhunës në Familje, e ndjekur nga Strategjia Kombëtare dhe Programi Kundër Dhunës në Familje. Megjithatë, 10 anëtarë nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, gjë e cila mund të interpretohet se ata nuk kishin

njohuri mbi strategjitë ekzistuese. Ndër dokumentet e tjera që lidhen me Dhunën në Familje, anëtarët listuan Procedurat Standarde Operative për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë nga 2013. CEDAW, Konventa për të Drejtat e Njeriut ishin dokumentet ndërkombëtare që janë përmendur më së shumti të cilat shërbejnë si bazë për ligjet e Kosovës.

Shënim krahasues: Në përgjithësi një informacion në rritje është gjetur nga viti 2012 lidhur me Ligjin për Barazi Gjinore dhe Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje dhe strategjitë kombëtare dhe komunale, edhe pse për të mëparshmin disa anëtarë kishin mungesë informacioni.

Në pyetjen nëse të anketuarit janë trajnuar mbi standardet / rregulloret lidhur me dhunën në familje 71% u përgjigjën se ata nuk ishin të trajnuar (figura 1). Pjesa e anëtarëve të trajnuar ka qenë më e lartë në sondazhin e vitit 2012, por duhet theksuar se në vitin 2012 vetëm 21 pyetësorë u plotësuan që është 16 më pak se në vitin 2015. Temat kryesore të trajnimeve janë: mbrojtja e të mbijetuarve të DhF, rehabilitimi i të mbijetuarve të DhF, re-integrimi i të mbijetuarve të DhF. Ofruesit kryesorë të trajnimit kanë qenë UN Women, OSBE, UNFPA, USAID, UNICEF, etj.

Figura 1: Nëse janë trajnuar mbi standardet / rregulloret lidhur me dhunën në familje, përgjigjet e vitit 2012 dhe 2015



Funksionimi i mekanizmave koordinues

Një pyetje ishte nëse institucioni i të anketuarit ka emëruar një person për mekanizmin koordinues dhe në 90 përqind të rasteve institucionet kanë emëruar një person dhe në 10 përqind të rasteve asnjë person nuk është emëruar (Figura 2). Në mesin e përfaqësuesve të emëruar 62 përqind janë femra dhe 38 përqind meshkuj (Figura 3).

Figura 2: Nëse është emëruar një person






Figura 3: Gjinia e personit të emëruar



Edhe pse 54 përqind e anëtarëve deklaruan se ata kanë munguar të paktën në një takim të mekanizmit koordinues, arsyeja kryesore ishte se ata ishin të zënë, por edhe se ata kanë dërguar dikë për ta përfaqësuar institucionin. Gjatë diskutimeve të grupit të fokusit është deklaruar se për të gjithë anëtarët pjesëmarrja në takimin e mekanizmit koordinues është një prioritet për ta, por kur ata janë shumë të zënë ata do të delegojnë dikë në mënyrë që të mos e humbasin takimin.

Në vitin 2012, 5 përqind e të anketuarve munguan në një takim pasi që ata ishin informuar me vonesë, ndërsa në vitin 2015 vetëm një person ka deklaruar se kishte munguar në takim për shkak të informimit me vonesë për takimin (Figura 4). Kjo e thekson rolin e koordinatorit për të caktuar takimet në kohë.


Figura 4: Arsyet e mungesës në takim, 2012 dhe 2015



Në vitin 2015, 84 përqind e të anketuarve vlerësuan se mekanizmi koordinues është shumë i dobishëm në mbështetjen e shërbimeve më të mira për të mbijetuarit e DhF dhe në përgjithësi në trajtimin e çështjeve të DhF dhe 16 përqind e vlerësuan si të dobishëm (Figura 5). Asnjë nga të anketuarit nuk kishte vërejtje dhe as nuk e përmendi si të padobishme, gjë që konfirmon rëndësinë e mekanizmit koordinues.

Duke krahasuar të dhënat në dy mënyra, një pjesë e madhe e anëtarëve e vlerësojnë mekanizmin si shumë të dobishëm.

Figura 5: Sa i dobishëm është mekanizmi koordinues



Në pyetjen për përfitimet që rrjedhin nga mekanizmi koordinues përgjigjet ishin si në vijim: forcohet bashkëpunimi midis institucioneve që janë pjesë e mekanizmit; përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara për të mbijetuarit e DhF; identifikimi i rasteve të DhF; ndarja e informacionit për rastet e DhF, çështjet dhe problemet; përmirësimi i raportimit dhe statistikave; lehtësim për punësim; menaxhim më i mirë i rastit, etj.

Sfida kryesore në funksionimin e mekanizmit koordinues ishte mungesa e buxhetit për mekanizmin në implementimin e Strategjive Komunale Kundër Dhunës në Familje. Në një rast një grup i madh i mekanizmit u përmend si një dobësi për funksionimin e mekanizmit.

Bazuar në dobësitë e raportuara për funksionimin e duhur të mekanizmit, të anketuarit u kërkuan të propozojnë çfarë duhet të ndryshohet për të përmirësuar dobësitë e cekura dhe propozimi më e shpeshtë ishte sigurimi i buxhetit për implementimin e strategjisë. Burimet e financimit të përmendura ishin komuna, por edhe donatorët.

Të dhënat në Figurën 6 përshkruajnë përgjigjet lidhur me nevojat për zhvillimin e kapaciteteve për institucionet e mekanizmit koordinues. Në sondazhin e vitit 2015 trajnimet në përmirësimin e

shërbimeve për të mbijetuarit e DhF përfaqësojnë nevojën më të shënuar; gjysma e të anketuarve pohojnë se ekziston nevoja për rritjen e njohurive mbi ligjet dhe rregulloret lidhur me DhF. Një e treta e të anketuarve deklaruan se trajnimet janë të nevojshme në lidhje me funksionimin e mekanizmit koordinues dhe 42 përqind konsiderojnë se ekziston nevoja për të përmirësuar aftësitë në hartimin e protokolleve dhe rregulloreve.

Duke krahasuar të dhënat nga dy sondazhet është e qartë se disa anëtarë e vlerësojnë nevojën për t'u trajnuar në fushën e funksionimit të mekanizmit koordinues. Kjo mund të tregojë një përmirësim të funksionimit të mekanizmit koordinues. Anëtarë të tjerë deklaruan nevojën e mëtejshme për të përmirësuar shërbimet për të mbijetuarit e DhF, trajnimet për ligjet dhe rregulloret dhe përgatitjen e protokolleve dhe rregulloreve të brendshme. Këto rezultate sugjerojnë se anëtarët e mekanizmit koordinues janë më të informuar dhe të vetëdijësuar për nevojat e të mbijetuarve të DhF, prandaj ata propozojnë se janë të nevojshme më shumë shërbime dhe / ose cilësi e përmirësuar e shërbimeve. Përveç kësaj, pasi mekanizmi është bërë më funksional ata kanë nevojë për më shumë aftësi në hartimin e dokumenteve të brendshme. Zhvillimi i strategjive komunale ka qenë

një nga aktivitetet të cilat gjithashtu kanë kontribuar në nevojat e zhvillimit të kapaciteteve të anëtarëve në zhvillimin e strategjive dhe planeve të veprimit. Në të ardhmen, zhvillimi i projekt propozimeve mund të jetë një temë e rëndësishme e trajnimit, pasi që mekanizmat koordinues duhet të paraqesin propozime të përgatitura mirë në Komunë dhe tek donatorët potencial.

3.2 Mbështetja e nevojshme në nivel qendror dhe lokal

Një tjetër pyetje e parashtruar ishte se çfarë duhet të bëjë qeveria qendrore në mënyrë që të ofrojë shërbime më të mira

për të mbijetuarit e DhF dhe përgjigjet e tyre janë paraqitur në figurën 7. Shtimi i një linje buxhetore për komunat për DhF është theksuar si intervenimi më adekuat nga ana e qeverisë qendrore- 80 përqind e të anketuarve kanë theksuar këtë masë. Në vitin 2015 intervenimi i dytë më i rëndësishëm është nevoja për të monitoruar implementimin e Ligjit për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje. Rreth gjysma e anëtarëve deklaruan se qeveria qendrore duhet të sigurojë implementimin e Strategjisë për Mbrojtje kundër Dhunës në Familje. Duke krahasuar rezultatet për vitin 2012 dhe 2015, alokimi i buxhetit ka mbetur intervenimi kryesor më i rëndësishëm që duhet ndërmarrë nga qeveria qendrore.

Figura 6: Nevojat e zhvillimit të institucioneve si pjesë e mekanizmave koordinues





Figura 7: Çfarë duhet të ndërmarrin institucionet e qeverisë qendrore për të ofruar shërbime adekuate për të mbijetuarit e DhF, % e anëtarëve



Pothuajse të gjithë anëtarët e propozuan alokimin e buxhetit për barazi gjinore.

3.3 Problemet kryesore me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DhF

Sipas anëtarëve koordinues sfida kryesore me të cilën ballafaqohen të mbijetuarit e DhF është pavarësia ekonomike dmth punësimi dhe kjo sfidë është më e përmendur në raundin e dytë të sondazhit. Sfida të tjera me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DhF janë: rehabilitimi; strehimi; mungesa e vendbanimit, socializimi dhe siguria e tyre. Është theksuar se edhe pse të mbijetuarit e DhF

Aplikimi i qasjes së buxhetimit gjinor duhet të zbatohet në të gjitha institucionet.

do të marrin të gjitha shërbimet e mundshme ekziston nevoja për të punuar në rehabilitimin e pronarëve të dhunës. Mungesa e mbështetjes së qëndrueshme në shtëpitë e sigurt gjithashtu është cekur një çështje e cila ka nevojë për një zgjidhje të përhershme. Qasja në asistencë sociale gjithashtu është përmendur si një çështje që duhet të jetë prioritet.

Për adresimin e këtyre sfidave janë bërë këto propozime: mbështetja nga qeveria qendrore, mbështetje financiare nga komunat; rritja e investimeve në strehimoret sociale; ngritja e vetëdijësimit për DhF dhe mbështetje nga donatorët. Në vitin 2012 sfida që është cekur më shumë


ishte mungesa e lokacioni / dhomës së duhur në stacionin e policisë, kur të mbijetuarit e DhF intervistohen, propozim i cili është implementuar në tre komuna.

3.4 Njohuri mbi BPGJ

Ndërsa në sondazhin e vitit 2012 shumica e anëtarëve e kuptuan BPGJ si një linjë të veçantë në nivel qendror për çështjet gjinore, në vitin 2015 BPGJ kuptohet si një buxhet prej të cilit si gratë ashtu dhe burrat përfitojnë në mënyrë të barabartë. Një interpretim tjetër ishte se BPGJ është buxheti i alokuar për qëllime të barazisë gjinore. Këto gjetje tregojnë se ka më shumë njohuri mbi BPGJ dhe kjo mund t'i atribuohet trajnimeve që janë organizuar në kohë midis dy sondazheve.

Të dhënat në Figurën 8 tregojnë se 29 përqind e anëtarëve konsiderojnë se institucioni i tyre aplikon buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, 45 përqind deklaruan se ky nuk është rasti dhe 26 përqind nuk janë të informuar nëse institucioni i tyre aplikon BPGJ. Anëtarët që u përgjigjën se institucioni i tyre aplikon BPGJ e shpjeguan këtë si më poshtë:

Figura 7: A aplikon institucioni juaj buxhetimin gjinor?



Nuk ka buxhet të qëndrueshëm në asnjë prej komunave për të mbijetuarit e DhF, por mbështetje është dhënë çdo vit dhe kjo në formën e mbështetjes për të shpëtuar shtëpi, mbështetje për të mbijetuarit e DhF dhe fëmijët e tyre gjatë qëndrimit të tyre në stacionin e policisë, ofrimi i strehimit të përkohshëm social dhe gjithashtu mbështetje për aktivitetet të cilat janë organizuar gjatë 16 Ditëve të Aktivizmit.

Për 70 përqind të anëtarëve të mekanizmave koordinues, nevojat e të mbijetuarve të DhF janë prioritet. Për të tjerët siç janë Qendra Rinore ky nuk është aktiviteti i tyre kryesor, por edhe ata punojnë në këtë fushë. Institucionet që janë pjesë e mekanizmit koordinues i identifikojnë nevojat e të mbijetuarve të DhF kryesisht përmes intervistave individuale me të mbijetuarit e DhF (70% e tyre). Kjo shifër ka qenë më e ulët në

vitin 2012 me 20 pikë përqindje dhe kjo mund të interpretohet si një zhvillim

pozitiv pasi kjo do të thotë se zëri dhe shqetësimet për DhF janë dëgjuar më mirë.

Tabela 3: Çfarë metodologjie aplikon institucioni juaj për të vendosur nevojat e të mbijetuarve të DhF si ‘prioritete të institucionit’

	2012	2015
Intervistat individuale	50	70
Grupet e fokusit	20	18
Takimet në komunitet	30	12
Numri i të anketuarve	100%	100

3.5 Zhvillimet në nivel qendror dhe lokal që nga viti 2012

Progresi i bërë në tre vitet e fundit ishte i tëri i lidhur me nivelin lokal dhe asnjë zhvillim nuk është përmendur në nivel qendror. Zhvillime pozitive janë vërejtur në nivel institucional, duke përfshirë: menaxhim më të mirë të rastit; shërbime më të mira në stacionin policor; ngritje e vetëdijësimit në shkolla dhe komunitet mbi DhF; progres në punësim dhe trainim dhe numri i shtuar i raportimit të rasteve të DhF. Në nivelin qendror zhvillimi i Procedurave Standarde të Operimit (PSO) për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë në vitin 2013 përbën një zhvillim të rëndësishëm. Qëllimi i PSO-ve është të

krijohet një sistem i koordinuar në të gjithë institucionet e Kosovës, të cilat reagojnë menjëherë dhe në vazhdimësi në rastet e dhunës në familje me qëllim të ofrimit të ndihmës cilësore dhe mbështetjes për viktimat e dhunës në familje. Si rezultat i kësaj, mekanizmat institucional dhe partnerë të tjerë do të harmonizojnë dhe të koordinojnë bashkëpunimin e tyre në faza të ndryshme që përfshijnë aktivitetet e identifikimit, referimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe re-integritit të viktimave të dhunës në familje dhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje. PSO-të do të përmirësojnë reagimin e shtetit në rastet e dhunës në familje, viktimat do të mbrohen nga viktimizimi sekondar dhe ato do të inkurajohen, të sigurohen dhe të fuqizohen që të distancohen nga marrëdhëniet e dëmshme dhe abuzive, si dhe të riintegrohen në një shoqëri të shëndoshë.

Duke iu referuar mekanizmave koordinues pothuajse të gjithë anëtarët deklaruan se mekanizmat koordinues janë bërë më funksional që nga viti 2012. Asnjë nga anëtarët nuk deklaroi se mekanizmi është bërë më pak funksional, por ka pasur disa që nuk kanë dhënë përgjigje. Faktorët kryesor që kanë kontribuar në rritjen e funksionalitetit të mekanizmave ishin: mbështetja e shtuar nga komuna dhe në Gjakovë konkretisht nga Kryetarja e Komunës, takimet e rregullta të mekanizmave dhe vijimi i rregullt i pothuajse të gjithë anëtarëve, diskutimet konstruktive, caktimet e koordinatorëve dhe koordinimi i mirë ndërmjet anëtarëve.

4.

Përfundime dhe rekomandime

Gjetjet nga ky hulumtim konfirmuan se është bërë progres në funksionimin e mekanizmit koordinues dhe mbështetjen e dhënë për të mbijetuarit e DhF që nga viti 2012 në tre komunat. Zhvillimet kryesore lidhur me mekanizmat koordinues janë të përshkruara më poshtë:

- ✓ MoU janë nënshkruar midis të gjitha institucioneve që janë pjesë e mekanizmave koordinues;
- ✓ Në çdo komunë është caktuar një koordinator, që ka lehtësuar organizimin dhe funksionimin e mekanizmave;
- ✓ Mekanizmat koordinues janë bërë plotësisht funksional. Tani zhvillohen takime të rregullta dhe ekziston një pjesëmarrje e përgjithshme e rregullt e anëtarëve.
- ✓ Për shkak të bashkëpunimit të shtuar të institucioneve është rritur efikasiteti i menaxhimit të rasteve, komuniteti është i informuar për ekzistencën dhe rolin e mekanizmave; ka pasur një rritje në raportim dhe në përgjithësi në ngritjen e vetëdijësimit të komunitetit në lidhje me DhF;
- ✓ Janë zhvilluar strategjitë komunale mbi mbrojtje kundër DhF, shoqëruar nga planet e veprimit dhe koston për secilin aktivitet. Kjo gjithashtu ka shërbyer si ushtrim për zhvillimin e kapaciteteve për të gjithë anëtarët pjesëmarrës;
- ✓ Për shkak të trajnimeve kanë avancuar njohuritë e anëtarëve për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, ligjet e fokusuara dhe dokumentet;

- ✓ Gjetjet tregojnë se diskutimet gjatë takimeve kanë çuar në identifikimin e sfidave me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DhF dhe gjithashtu mënyrave se si ato mund të adresohen. Për shembull, ndërsa në vitin 2012 sfida kryesore është përmendur të jetë siguria dhe strehimi, në vitin 2015 re-integrimi dmth fuqizimi ekonomik ishte një tjetër sfidë kryesore që është përmendur nga anëtarët;
- ✓ Anëtarët e mekanizmave bashkërisht kanë organizuar dhe implementuar aktivitetet gjatë 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës në Familje mbi Baza Gjinore;
- ✓ Disa nga të mbijetuarit e DhF kanë marrë pjesë në kurset e trajnimit dhe gjithashtu disa janë punësuar përmes Zyrave Publike të Punësimit;
- ✓ Edhe pse në Kosovë nuk ekziston aplikimi i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator, pjesëtarët e mekanizmave koordinues janë mirë të informuar për qasjen dhe mbështesin nevojën për implementimin e BPGJ në institucionet e tyre;
- ✓ Të gjithë anëtarët e ndajnë mendimin se mekanizmat koordinues janë të qëndrueshme

dmth nuk varen nga mbështetja nga donatori, por për përdorimin më të mirë të mekanizmave, mbështetja financiare për organizimin e aktiviteteve konsiderohet e nevojshme;

- ✓ Është vërejtur mungesë e bashkëpunimit të mekanizmit koordinues në Dragash dhe shtëpisë së sigurt në Prizren.

Në nivel lokal është konfirmuar një gatishmëri e shtuar për të mbështetur mekanizmat dhe aktivitetet në fushën e DhF. Edhe pse komunat kanë mbështetur financiarisht organizimin e disa aktiviteteve dhe kanë mbështetur të mbijetuarit e DhF, ende nuk ka buxhet specifik të alokuar as për mekanizmin as për shërbimet për të mbijetuarit e DhF. Ekziston përkushtimi për caktimin e një buxheti për mekanizmin koordinues në komunën e Gjakovës në vitin 2016 dhe përkrahja për të mbështetur të mbijetuarit e DhF është angazhuar në dy komunat tjera. Ngjashëm me vitin 2012 në vitin 2015 nuk ka buxhet në dispozicion për zyrtarët për barazi gjinore, i cili do të përdoret edhe për aktivitetet në fushën e DhF.

Rekomandimet

Pavarësisht progresit të arritur, ekziston ende hapësirë për të përmirësuar mbështetjen për të mbijetuarit e DhF, e cila mund të arrihet përmes masave dhe intervenimeve në vijim:

- ✓ Mbështetja e qëndrueshme financiare nga komunat është e nevojshme për mekanizmat koordinues;
- ✓ Mbështetja e qëndrueshme financiare për shtëpitë e sigurta;
- ✓ Zhvillimi i kapaciteteve për koordinatorët në përgatitjen e projekt propozimeve; raportim; monitorim dhe lobim;
- ✓ Lehtësimi i punësimit dhe aftësimi i të mbijetuarve të DhF. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të përfshijë të mbijetuarit e

DhF në mesin e grupeve prioritare për të përfituar nga programet e trajnimit dhe punësimit;

- ✓ Deri më tani të gjitha burimet janë përdorur për të punuar me të mbijetuarit e DhF dhe nuk ka asnjë program të disponueshëm për trajtimin e kryerësve;
- ✓ Trajnimi i policëve në intervistimin e fëmijëve;
- ✓ Trajnimi i mjekëve në përshkrimin e lëndimit, pasi ky është një element i rëndësishëm për gjykimin;
- ✓ Trajnimi i gazetarëve që ata të raportojnë në mënyrë adekuate mbi DhF; dhe
- ✓ Më shumë aktivitete me shkollat pasi kjo për një kohë të gjatë do të kontribuoj në reduktimin e rasteve të DhF.

Shtojca 1: Pyetësi

UNWOMEN, Kosovë

2015

**Pyetësor lidhur me funksionalizimin e mekanizmit koordinues lidhur me DhF dhe
nevojat e zhvillimit të institucioneve të përfshira në mekanizmin, në komunën e
Dragashit, Gjakovës dhe Gjilanit**

Qëllimi i këtij pyetësi është mbledhja e informacioneve në lidhje me funksionimin e mekanizmit koordinues të përbërë nga institucionet që ofrojnë shërbime për të mbijetuarit e dhunës në familje dhe gjithashtu për të identifikuar nevojat e zhvillimit të këtyre institucioneve duke përfshirë temën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si një koncept i ri që prodhon ndikim të dobishëm në shoqëritë demokratike që promovojnë barazinë gjinore. Të dhënat do të analizohen dhe përfshihen në një raport i cili do të shërbejë si bazë për të hartuar trajnime dhe aktivitete të tjera me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të ofruar për të mbijetuarit e dhunës në familje në Kosovë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

Pyetësori

1. Institucioni: 1.1. Komuna
2. Pozita:
3. Gjinia: 1. Femër 2. Mashkull
4. Moshë:

V. Niveli i njohurive mbi Ligjet dhe dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare me rëndësi për dhunën në familje mbi baza gjinore.

5. A mund të emëroni ligjet kombëtare, strategjitë dhe planet që mbështesin / promovojnë barazinë gjinore në Kosovë me fokus në dhunën në familje mbi baza gjinore.

5.1 Ligjet

5.2 Strategjitë

5.3 Dokumente tjera

6. A keni njohuri mbi Ligjin e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje?
2. Po 2. Jo

7. A mund të emëroni dokumentet ndërkombëtare lidhur me barazinë gjinore të cilat janë bazë për ligjet kombëtare me fokus në dhunën në familje mbi baza gjinore.

8. Që nga viti 2012 a keni marrë ndonjëherë trajnim në punë në lidhje me standardet / rregulloret themelore të punës lidhur me rastet e dhunës në familje?

3. Po
4. Jo

8.1. Nëse Po, cilat institucione / organizata kanë ofruar trajnime dhe kur?

Institucioni	Viti	Tema

VI. Roli dhe niveli i aktiviteteve nga mekanizmi dhe nevojat e zhvillimit të kapaciteteve

9. Në cilin vit është bërë institucioni juaj anëtare e mekanizmit koordinues?

10. A ka emëruar institucioni juaj një person për të marrë pjesë në takimet e mekanizmit koordinues?

- Po
- Jo
- Nuk e di

10.1 Nëse po, ju lutem tregoni pozitën e tij / saj në institucion dhe gjininë tij / saj

10.1.1 Pozita

10.1.2 Gjinia

11. Sa herë keni marrë pjesë në takimin e mekanizmit koordinues gjatë vitit 2014?

_____ herë

12. A keni munguar në ndonjë takim:

2. Po 2. Jo

12.1. Nëse keni munguar në një takim cila ishte arsyeja?

1. Zënë në punë
2. Jam informuar me vonesë
3. Arsye të tjera (ju lutemi specifikoni)

13. Sa të dobishme e shihni ekzistencën e mekanizmit koordinues?

2. Shumë të dobishme 2. Të dobishme 3. Pak a shumë të dobishme 4. Të padobishme

14. A mund të emëroni tre përfitimet kryesore që dalin nga mekanizmi koordinues?

- 1.
- 2.
- 3.

15. A mund të emëroni tre dobësitë kryesore në mbarrëvajtjen e mekanizmit deri më tani?

- 1.
- 2.
- 3.

16. Çfarë duhet të ndryshohet që mekanizmi koordinues të punojë në mënyrë efektive, nëse ka nevojë?

- 1.
- 2.
- 3.

17. Cilat janë nevojat e zhvillimit të institucionit tuaj lidhur me DhF si pjesë e mekanizmit koordinues?

1. Trajnime mbi ligjet dhe rregulloren
2. Trajnime në përmirësimin e shërbimeve për të mbijetuarit e DhF
3. Trajnime për mënyrën e funksionimit të përgjigjes së koordinuar të komunitetit kundër dhunës ndaj grave / DhF (mekanizmi koordinues)
4. Hartimi i protokolleve të brendshme / rregulloreve / MoU për të lehtësuar punën e mekanizmit koordinues (nëse nuk ekziston një MoU i tillë)
5. Mbështetje shtesë për përmirësimin e funksionimit të mekanizmit koordinues (ju lutem specifikoni)

18. Cilat mendoni se janë tre çështjet / problemet më të mëdha të mbijetuarve të DhF lidhur me fushën tuaj të punës?

- 1.
- 2.
- 3.

19. Nëse ka çështje që duhet të trajtohen si mund të zgjidhen ato?

20. Çfarë mendoni se duhet të bëjnë institucionet qendrore qeveritare (dmth Ministria përkatëse) për të siguruar që të mbijetuarit e DhF të marrin shërbime më të përshtatshme në nivel lokal?

1. Të shtohet një linjë buxhetore për komunat për DhF
2. Të sigurohet implementimi i plotë i strategjisë për Mbrojtje kundër DhF
3. Të monitorohet implementimi i Ligjit për Mbrojtje kundër DhF

4. Të tjera (ju lutem specifikoni)

VII. Niveli I njohurive mbi BPGJ

21. Çfarë nënkuptoni me BPGJ?

22. A e përdorni BPGJ-në si një mjet planifikimi në institucionin tuaj?

1. Po;
2. Jo;
3. Nuk e di

22.1 Nëse PO, a mund të përshkruani si e përdorni atë (për çfarë qëllimesh dhe kur saktësisht)?

22.2 Nëse jo, pse mendoni se institucioni juaj nuk e përdor BPGJ-në?

23. Komuna në të cilën ju veproni, a e bën ndarjen e buxhetit për mbështetje për të mbijetuarit e DhF?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di

23.1 Nëse Po, a keni njohuri se cila është % e këtij buxheti në buxhetin total të komunës për një vit?

24. A I jep prioritet institucioni juaj nevojave të mbijetuarve të DhF?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di

24.1 Nëse PO, si realizohet kjo, ju lutem tregoni metodologjinë e përdorur

1. Intervistat individuale
2. Grupet e fokusit
3. Takimet në komunitet
4. Të tjera? (ju lutem specifikoni)

VIII. Zhvillimet që nga viti 2012

25. Krahasuar me vitin 2012 sipas mendimit tuaj a është mekanizmi koordinues më funksional?

1. Po 2. Jo

25.1 Nëse mekanizmi koordinues është bërë më funksional ju lutemi tregoni çfarë ka kontribuar në këtë

- 1.
- 2.
- 3.

25.2 Nëse mekanizmi koordinues është bërë më funksional ju lutemi tregoni pse ka ndodhur kjo?

- 1.
- 2.
- 3.

26. Në tre vitet e fundit a ka pasur zhvillime pozitive në nivel qendror për të mbështetur të mbijetuarit e DhF?

1. Po 2. Jo

26.1 Nëse P26 = 1 atëherë ju lutemi shënoni tre zhvillimet më të rëndësishme.

- 1.
- 2.
- 3.

27. Në tre vitet e fundit a ka pasur zhvillime pozitive në nivel lokal për të mbështetur të mbijetuarit e DhF?

27.1 Nëse P27 = 1 atëherë ju lutemi shënoni tre zhvillimet më të rëndësishme.

- 1.
- 2.
- 3.

28. Në tre vitet e fundit a ka pasur zhvillime pozitive në nivelin tuaj institucional për të mbështetur të mbijetuarit e DhF?

1. Po 2. Jo

28.1 Nëse Q28 = 1 atëherë ju lutemi shënoni tre zhvillimet më të rëndësishme.

- 1.
- 2.
- 3.

IX. Komentet dhe propozimet

29.1 Ju lutem shtoni ndonjë koment që mund të keni

29.2 Ju lutem shtoni ndonjë propozim që mund të keni

Data e intervistës:

Studimi Bazë-Alokimi i buxhetit për shërbimet e DHF në nivel komunal; funksionaliteti i mekanizmave koordinues dhe njohuri mbi BPGJ në komunat e Kosovës Veriore (Mitrovica e Veriut, Zveçani, Leposaviçi dhe Zubin Potoku)/Qershor 2015

1. Hyrje dhe qasje në metodologji	82
2. Përshkrimi i rrugës nëpër të cilën kallojnë të mbijetuarit e dhunës në familje në Kosovë.....	84
3. Mekanizmat ekzistues për adresimin e DHF dhe mbështetjen e të mbijetuarve të DHF ...	85
4. Sfidat me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DHF	87
5. Procedurat buxhetore dhe mbështetja komunale për të mbështetur të mbijetuarit e DHF ..	88
6. Gjetjet nga sondazhi.....	89
6.1 Sfidat me të cilat përballen të mbijetuarit e DHF dhe si mund të trajtohen ato	89
6.2 Koordinimi mes institucioneve në lidhje me të mbijetuarit e dhunës në familje	90
6.3 Kontributi nga komunat dhe njohuri mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.....	91
6.4 Njohuri mbi ligjet dhe strategjitë	92
7. Përfundime dhe rekomandime	92
Referencat	94
Shtojca 1: Pyetësi.....	95
Shtojca 2: Lista e personave të intervistuar	101

1.

Hyrje dhe qasje në metodologji

Dhuna në familje në baza gjinore paraqet një çështje që karakterizon shoqërinë kosovare. Pavarësisht progresit të arritur ka shumë hapësirë për të punuar në parandalimin, raportimin e rasteve, për të siguruar sigurinë dhe strehimin, ofrimin e shërbimeve adekuate dhe cilësore, lehtësimin e rehabilitimit të pronarëve dhe mbështetjen e të mbijetuarve të DHF në re-integrimin e tyre përmes fuqizimit ekonomik dhe re-integrimin në jetën sociale. Ky studim është i pari për katër komunitat në veri të Kosovës, i cili fokusohet në vlerësimin e sfidave me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DHF, duke përshkruar rrugën nëpër të cilën kalojnë të mbijetuarit e DHF, shërbimet e disponueshme për të mbijetuarit e DHF dhe mekanizmat e caktuar për mbështetjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të angazhuara në mbrojtjen dhe mbështetjen e të mbijetuarve të DHF. Studimi synon të identifikojë nevojat e mëtejshme për ndihmën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të përfshira, e cila nga ana tjetër do të lehtësojë ofrimin e mbështetjes më të mirë dhe të një cilësie të lartë.

Aktualisht nuk ka të dhëna zyrtare mbi përhapjen e dhunës në familje në veri të Kosovës. Kjo ndodh për shkak se institucionet në veri të Kosovës nuk mbajnë shënime mbi rastet e dhunës në familje (Waugh, 2013). Megjithatë, të dhënat janë të disponueshme vetë në nivel të stacionit policor. Në mënyrë të ngjashme, stacioni kryesor i policisë në pjesën jugore të Mitrovicës regjistron raste të DHF, por ato nuk ndahen me institucionet në pjesën veriore. Kjo mungesë e shkëmbimit të informacionit konsiderohet si një pengesë për zhvillimin e një strategjie kohezive për të trajtuar dhunën në familje në veri të Kosovës (Waugh, 2013). I njëjti studim i kryer arriti në përfundimin se ekziston nevoja për një qasje gjithëpërfshirëse duke përfshirë fushata publike, trajnime të kapaciteteve për punonjësit komunal, krijimi i një shtëpie të sigurt si dhe lehtësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike.

Për të arritur këto synime janë realizuar intervista me institucionet relevante dhe një pyetësor është plotësuar nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen dhe mbështetjen e të mbijetuarve të DHF. Intervistat janë zhvilluar me institucionet në vijim: Drejtorët e Departamentit të Financave në Komunën e Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut, Leposaviçit dhe Zveçanit janë intervistuar për të kuptuar pikat e mëposhtme: procedurat e buxhetimit në nivel komunal; si janë caktuar prioritetet dhe si është përgatitur buxheti në bazë të këtyre prioritetëve; nëse komuna ndan buxhetin për Aktivitetet për Dhunën në Familje; nëse dhe çfarë lloji i shërbimeve janë të mbështetura

financiarisht nga komuna dhe nga e cila linjë buxhetore; për të kuptuar procesin me pjesëmarrje të qytetarëve në përgatitjen e buxhetit. Informacioni më i rëndësishëm që synohet të arrihet nga intervista me Drejtorët e Departamentit të Financave ishte identifikimi i linjës buxhetore që mund të përdoret për alokimin e buxhetit për shërbime ndaj të mbijetuarve të DHF.

Qendrat për punë sociale janë intervistuar dhe tema e diskutimeve u fokusua në identifikimin e llojit të mbështetjes dhe shërbimeve që ofrojnë Qendrat për të mbijetuarit e dhunës në familje; të kuptuarit nga perspektiva e Qendrës e sfidave kryesore me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit; identifikimi i sfidave me të cilat ballafaqohen Qendrat për Punë Sociale në mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës në familje; buxheti i disponueshëm për mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës në familje; dhe mbledhja e informacioneve të tjera përkatëse që ata mund të ofrojnë në lidhje me DHF në komunën e tyre.

Qëllimi i studimit ishte për të intervistuar zyrtarët për barazi gjinore (BGJ) në secilën komunë, por gjatë punës në terren u kuptua se këto komuna nuk kanë zyrtarë për barazi gjinore. Vetëm komuna e Zveçanit kishte një zyrtar, por pasi ai person kishte ndërruar jetë, pozita ka mbetur boshe dhe tani po zhvillohen diskutime për të plotësuar vendin. Një tjetër grup i synuar për studim ishin shtëpitë e sigurta, por nuk ka asnjë shtëpi e sigurt në katër komuna. Intervistat janë zhvilluar me organizatat e mëposhtme të shoqërisë civile: Zensko Pravo dhe OJQ-ja Aktiv. Diskutimet me OJQ-të janë fokusuar mbi temat vijuese: Cilat janë sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e dhunës në familje; a është mbështetja e

mjaftueshme dhe në cilat fusha nevojitet më shumë mbështetje; në çfarë mënyre organizatat e shoqërisë civile kanë mbështetur të mbijetuarit e dhunës në familje; a marrin pjesë organizatat e shoqërisë në dëgjimet publike të komunave për buxhetin; cili është mendimi i tyre për krijimin e një mekanizmi koordinues në secilën komunë për mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës në familje dhe koordinim më të mirë të aktiviteteve; sa është i mbështetur re-integrimi i të mbijetuarve të dhunës në familje dhe mbledhja e çdo informacioni tjetër të cilin ata e shohin me interes për fushën e tyre të punës për DhF.

Sondazhi u realizua me institucionet e mëposhtme: Qendrat për Punë Sociale (3 drejtorët), Zyrtarët e Policisë (4), mbrojtësit e të mbijetuarve të DHF (2), dhe një gjykatës. Pyetësi përbëhet nga katër pjesë kryesore: pjesa e parë përmban pyetje në lidhje me pengesat kryesore që DHF mbijetuarit përballen; Pjesa e dytë fokusohet mbi çështjen e ccoordination ndërmjet institucioneve të përfshira lidhen me dhunës në familje Mbijetuarit, pjesa e tretë trajton pyetje mbi mbështetjen financiare të ofruara nga komuna për shërbimet për të mbijetuarit DHF dhe gjithashtu temën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe pjesa e fundit përmban pyetje të vlerësojë njohuritë e të intervistuarve mbi ligjet dhe dokumentet ndërkombëtare me rëndësi për barazinë gjinore.

Pyetësi përbëhet nga katër pjesë kryesore: pjesa e parë përmban pyetje në lidhje me pengesat kryesore me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DHF; Pjesa e dytë fokusohet mbi çështjen e koordinimit ndërmjet institucioneve të përfshira në

lidhje me të mbijetuarit e Dhunës në Familje, pjesa e tretë trajton pyetje mbi mbështetjen financiare të ofruar nga komuna për shërbimet për të mbijetuarit e DHF dhe gjithashtu temën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe pjesa e fundit përmban pyetje për vlerësimin e njohurive të intervistuarve mbi ligjet dhe dokumentet ndërkombëtare me rëndësi për barazinë gjinore.

Informacione të vlefshme janë mbledhur gjatë takimit teknik që është organizuar nga Agjencitë e Kombeve të Bashkuara (UNDP, OHCHR, UN Women, UNICEF, UNFPA, FAO) në veri të Mitrovicës më 16 qershor. Në këtë takim ishin të pranishme institucionet relevante dhe OJQ-të aktive në çështjet gjinore. Diskutimi u fokusua në sfidat me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DHF, shërbimet në dispozicion dhe mbështetja e mëtejshme e nevojshme për të shërbyer më mirë dhe për të lehtësuar re-integrimin e të mbijetuarve të DHF.

2.

Përshkrimi i rrugës nëpër të cilën kallojnë të mbijetuarit e dhunës në familje në Kosovë

1. Një i mbijetuar i dhunës në familje ose një dëshmitar raporton për dhunën në familje në Polici. Njësia Policore shkon në vend dhe një zyrtar i policisë i trajnuar posaçërisht për punë me viktimat e dhunës në familje, vazhdon me rastin. Shumë e stacioneve policore në veri kanë një zyrtar të caktuar i cili është i ngarkuar për trajtimin e dhunës në familje dhe shumë prej tyre janë trajnuar në trajtimin e rasteve të tilla si në nivel lokal dhe jashtë vendit (Waugh, 2013);
2. Në rast se ka shenja të dukshme të dhunës fizike, viktimat dërgohet në qendër shëndetësore për ekzaminim, dhe përgatitet një raport;
3. Policia thërret përfaqësues të Qendrës për Punë Sociale, dhe përfshihet ekipi i tyre i ekspertëve për dhunën në familje, veçanërisht nëse në këtë rast është i përfshirë një fëmijë. Në veri të Kosovës ekzistojnë tre Qendra për Punë Sociale të cilat gjenden në komunat e: Mitrovicës së Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Në rastet e dhunës në familje, Qendra për Punë Sociale ka për detyrë ndërlidhjen me policinë lokale dhe gjykatat, për t'u siguruar se viktimës i është dhënë mbrojtja e duhur dhe për të siguruar mbështetje psikologjike dhe materiale. Qendrat për Mirëqenie Sociale për të mbijetuarit e DHF ofrojnë mbështetje psiko-sociale përmes psikologut, mbështetje financiare (40-80 Euro në varësi të numrit të fëmijëve) dhe gjithashtu shërbime këshillimi. Nuk ka buxhet të veçantë për viktimat e dhunës në

familje, përveç buxhetit i cili është paraparë për mirëqenie sociale, i cili ofrohet nga buxheti i Serbisë dhe i Kosovës. Ekziston një ndihmë në formën e pagës mujore nga buxheti i Serbisë dhe i Kosovës. Mbështetja financiare fillimisht është e dedikuar për prindër të vetëm, në këto raste gratë.

4. Policia informon mbrojtësin e viktimës, i cili informon viktimën mbi të drejtat dhe mundësitë e tij / saj, dhe merr një deklaratë nga viktimja. Mbrojtësi i viktimës e shoqëron viktimën nëpër të gjitha fazat e rastit;
5. Viktimës i rekomandohet akomodimi në një shtëpi të sigurt, e cila ndodhet në jug, por deri tani asnjë nga të mbijetuarit e DHF nuk e ka pranuar këtë mundësi për shkak të vendndodhjes. Hapa konkretë janë ndërmarrë në ndërtimin e një shtëpie të sigurt. Komuna e Mitrovicës Veriore ka dhuruar tokën, është zhvilluar plani arkitektural dhe ka diskutime të vazhdueshme me Ambasadën e Finlandës për mbështetjen e ndërtimit.
6. Prokurori informohet, i cili e fillon rastin, paraqet akuzat dhe çështja procesohet më tej në gjykatë. Gjykata në Vushtrri është përgjegjëse për lëshimin e urdhrave mbrojtës, por nuk ka bashkëpunim në mes të gjykatës dhe Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicën e Veriut ose në komunat e tjera në tërë veriun e Kosovës (Waugh, 2013).

Nga intervistat gjithashtu është gjetur se Qendra lokale e Shëndetit Parësor (Dom zdravlja) posedon një protokoll për trajtimin e çështjeve për të cilat dyshohet dhuna në familje. Kur mjekët përcaktojnë se dhuna në familje ka ndodhur, përgatitet një raport dhe informohet policia. Ky është një bashkëpunim i mirë ndërmjet klinikave shëndetësore dhe policisë, por bashkëpunimi i dobët ndërmjet klinikave shëndetësore dhe qendrave për punë sociale është raportuar nga një studim i kohëve të fundit (Waugh, 2013). Kjo ka vënë në dukje nevojën për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të përfshira në fushën e DHF.

3.

Mekanizmat ekzistues për adresimin e DHF dhe mbështetjen e të mbijetuarve të DHF

Gjatë këtij hulumtimi janë identifikuar mekanizmat koordinues/ bashkëpunues të mëposhtëm:

1. Në çdo komunë ekziston një grup joformal i anëtarëve gra të kuvendit, themeluar me vet

iniciativën e grave. Qëllimi i grupit është që të adresojë temën e dhunës në familje dhe promovimin e barazisë gjinore në komunë. Qëllimi i këtyre grupeve është që të zhvillojnë një plan veprimi i cili do të kontribuojë në zhvillimin e aktiviteteve dhe procedurave konkrete në nivel komunal për të promovuar barazinë gjinore dhe adresuar dhunën në familje në baza gjinore. Megjithatë, të kufizuara nga kufizimet financiare asnjë aktivitet nuk është ndërmarrë deri tani.

- Në qershor të vitit 2014, OJQ-ja AKTIV në veri të Mitrovicës ka krijuar një task forcë e cila është themeluar si pjesë e projektit *"Fuqizimi i Përgjigjes Institucionale Ndaj Dhunës në Familje në Veri të Kosovës"*. Qëllimi e këtij projekti ishte vendosja e themeleve për ndërtimin e shtëpisë së sigurt në veri të Kosovës dhe gjithashtu do të ofrojë një sërë trajnimesh për punonjësit e policisë, punonjësit socialë dhe zyrtarë të tjerë komunalë për të punuar me viktimat dhe për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në mënyrë më efektive. Task forca përbëhet nga përfaqësues nga institucionet e mëposhtme: Qendra për Mirëqenie Sociale në Zubin Potok; Mitrovica veriore, Zveçani dhe Leposaviqi; Drejtori e Qendrës shëndetësore nga Leposaviqi, përfaqësuesit e tre OJQ-ve për çështje gjinore (Maras; Zdravljë; dhe Santa Marija); një përfaqësues i komunës të Zveçanit; një nga Gjykata Themelore; përfaqësues të Policisë së Kosovës në Leposaviq dhe Mitrovicën e Veriut, dhe përfaqësues nga dy OJQ tjera.

Siç përcaktohet në MoU, Task Forca së në bashkëpunim dhe në konsultim me Menaxherin e Projektit ka këto detyra kryesore: të mbajë takime të rregullta koordinuese (varësisht nga disponueshmëria e anëtarëve të Task Forcës) në udhëheqjen e ngjarjeve të aktiviteteve të projektit; të zhvillojë një vizitë studimore një shtëpinë e sigurt në Bijelinë, Republika Srpska, Bosnjë e Hercegovinë, për të përcaktuar se cilat praktika më të mira mund të zbatohen në veri të Kosovës; të lëshojë një raport mbi vizitën studimore të shkruar nga Menaxheri i Projektit i cili do të përshkruajë gjetjet nga vizita studimore, si dhe cilat praktika mund të implementohen në veri të Kosovës; të sigurojë ndihmë dhe të mundësojë një vlerësim të detajuar të nevojave të institucioneve publike lokale, i cili do të vlerësojë burimet që ata aktualisht kanë, si dhe të identifikojë nevojat e institucioneve vendore në rritjen e kapaciteteve për t'u marrë me dhunën në familje në mënyrë më efektive; dhe të identifikojë aktorët kryesorë lokal në nivel institucional të cilët do të marrin pjesë në trajnimet e ofruara nga AKTIV. Task Forca është projektuar të jetë e qëndrueshme dhe do të ketë një rol në udhëheqjen e krijimit të shtëpisë së sigurt në pjesën veriore të Mitrovicës. Qëllimi I AKTIV është që të vazhdojë të punojë ngushtë me ata gjatë këtij projekti dhe të vazhdojnë të përdorë atë si një mekanizëm thelbësor mbështetës (intervistë me OJQ AKTIV). Gjatë intervistës me përfaqësues të OJQ-së AKTIV është theksuar se ekziston nevoja për një mekanizëm të qëndrueshëm koordinues i cili do të bashkojë të gjitha

institucionet relevante. Kjo pastaj do të kontribuojë për bashkëpunim më të mirë midis institucioneve dhe ofrimin e shërbimeve adekuate për të mbijetuarit e dhunës në familje.

4.

Sfidat me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DHF

Ky seksion raporton gjetjet nga sondazhi I realizuar në kuadër të këtij hulumtimi, intervistat e zhvilluara dhe gjithashtu rezultatet nga takimi teknik i mbajtur në veri të Kosovës në qershor të vitit 2015. Në very të Kosovës gratë janë subjekt i dhunës në familje dhe faktori më I zakonshëm I vërejtur që çon në dhunë është alkooli dhe përdorimi I drogës nga burrat, por edhe kushtet e rënda ekonomike. Duke u mbështetur në gjetjet nga intervistat dhe sondazhet, sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DHF janë si më poshtë:

- Mungesa e shtëpive të sigurt, të cilat në fund I shtynë gratë të rikthehen tek dhuna;
- Gjendja e vështirë ekonomike e të mbijetuarve të DHF, të cilat nuk kanë mundësi, më pas kthehen përsëri tek dhuna;
- Mungesa e strehimoreve sociale që mund të përdoret nga të mbijetuarit e DHF;

- Mungesa e programeve të rehabilitimit psiko-social-ekonomik për gratë;
- Prania e stigmatizimit nga shoqëria, ku dhuna në familje është ende një tabu, që parandalon gratë të kërkojnë ndihmë;
- Mungesa e informimit të grave mbi të drejtat e tyre dhe mbështetjes në dispozicion;
- Sanksionet e dobëta /lehta, të cilat nga ana tjetër nuk kontribuojnë në parandalimin e dhunës në familje dhe demotivojnë raportimin e rasteve të DHF;
- Zbatimi i dobët i urdhrave të lëshuara të mbrojtjes;
- Vetëdijësimi i dobët mbi pasojat për ata që ushtrojnë dhunë;
- Bashkëpunimi i dobët mes institucioneve që janë relevante për të mbështetur të mbijetuarit e DHF;
- Re-integrimi i të mbijetuarve të dhunës në familje;
- Struktura ligjore dhe e gjykatës është, ose e dobët ose nuk ekziston fare dhe rrjedhimisht implementimi i ligjeve për rregullimin e dhunës në familje është i kufizuar (Waugh, 2013). Pasi që gjykata më e afërt gjendet në Vushtrri, disa gra nga Kosova veriore ndjekin veprimet ligjore përmes sistemit gjyqësor (në vitin 2013 është raportuar se Gjykata në Vushtrri ka ndjekur penalisht 15 raste të dhunës në familje të raportuara nga veriu i Kosovës).

5.

Procedurat buxhetore dhe mbështetja komunale për të mbështetur të mbijetuarit e DHF

Shefi e financave në Zubin Potok shpjegoi procesin e propozimit të buxhetit sipas sistemit të Kosovës. Sipas ligjit çdo drejtori në administratën komunale duhet të propozojë një buxhet, por pasi që komuna e Zubin Potokut nuk ka drejtori, buxheti propozohet nga departamenti i financave. Buxheti propozohet bazuar në tre kritere: bazuar në buxhetin e vitit të kaluar; bazuar në nevojat e komunës dhe bazuar në atë se kush është e miraton buxhetin dmth financimi (Qeveria e Kosovës). Pas dorëzimit të propozimit të buxhetit nga departamenti e financave, dhe me konsultim me ministrinë kompetente, organizohet dëgjimi publik, ku qytetarët, përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatat e tjera mund të shprehin nevojat dhe pikëpamjet e tyre mbi propozimin e buxhetit, edhe pse pjesëmarrja mbetet shumë e kufizuar si nga qytetarët ashtu dhe nga organizatat e shoqërisë civile. Pas dëgjimeve publike propozimi i buxhetit dërgohet në kuvendin komunal për miratim.

Përfaqësuesi i departamentit të financave në komunën e Leposaviqit citon se ka disa çështje kur bëhet fjalë për financimin nga qeveria e Kosovës. Çështja është se buxheti bazohet në numrin e qytetarëve të komunës, territorin dhe në disa faktorë të tjerë, por për shkak të dhënave të pasakta nga regjistrimi, buxheti është dukshëm më i ulët sesa nevojat reale të komunës. Shefi i Financave të komunës së Zveçanit u ankua se sistemi i centralizuar i Kosovës nuk është fleksibël dhe cakton vetëm limite dhe kjo nuk lejon ndarjen e fondeve për prioritetet e tjera.

Komunat në veri të Kosovës nuk kanë linjë të veçantë buxhetore për dhunën në familje. Shefi e financave nga komuna e Mitronicës ka deklaruar se nuk ka pasur kërkesa nga të mbijetuarit e DHF për ndonjë mbështetje. Shefi e financave të komunës së Zveçanit përmendi një rast ku komuna ka mbuluar shpenzimet e qirasë për një të mbijetuar të dhunës në familje për dy vjet dhe disa raste të tjera të cilat janë të mbështetura financiarisht nga buxheti i komunës. Për familjet që jetojnë në kushte të vështira dhe gjithashtu për të mbijetuarit e DHF ekziston një ndihmë, mesatarisht në shumën prej 100 euro të paguara nga të hyrat vetanake të komunës.

Megjithëse nuk ka linjë buxhetore për shërbimet në lidhje me DHF në komuna, shefi I intervistuar i financave tha se kjo mund të arrihet përmes linjës buxhetore për programin social ose kujdesin shëndetësor. Nga intervistat me shefat e financave në katër komunat është theksuar fuqishëm vullneti për alokimin e buxhetit për mbështetjen e të mbijetuarve të DHF. Megjithatë, propozimet duhet të adresohen në komunë dhe kjo nuk ka ndodhur deri

më tani. Shefi i financave në komunën e Zubin Potokut theksoi se planet dhe strategjitë për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje janë duke u zhvilluar.

Nuk ka një buxhet të veçantë për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje por ekziston një buxhet i përgjithshëm për QPS-së nga të cilat fondet janë shpërndarë për mirëqenie sociale. Një pjesë e këtij buxheti është financuar nga ministria serbe dhe një pjesë është siguruar nga komunat. Buxheti është përcaktuar në bazë të propozimit të QPS-së në ministri sipas vitit të kaluar financiar e cila varet nga numri i qytetarëve dhe madhësia e komunës. Komunat gjithashtu mund të kenë një mbështetje financiare afatshkurtër të dhuruar nga e ashtuquajtura Zyra për Kosovë dhe Metohi buxheti i së cilës është llogaritur në bazë të gjendjes ekonomike të familjes dhe kjo është zakonisht midis 20.000 deri në 50.000 dinarë (170-420 euro).

institucioneve në komunat në veri të Kosovës është kryer vëzhgimi vetëm me QPS, oficerët e policisë, mbrojtës DV dhe një gjyqtar. Pasi që vetëm 10 pyetësorë u plotësuan të dhënat mund të analizohen vetëm nga raportimi i numrit të rasteve dhe jo nga përqindjet (kjo për shkak se nëse një prej tyre largohet atëherë personat përgjigjen me Po në një pyetje, atëherë kjo do të llogaritet si 10%, por ky është vetëm një person kështu që kjo siguron një informacion mashtrues). Megjithatë, mesataret janë të rëndësishme dhe kur janë të aplikueshme do të raportohen.

Pyetësori u plotësua nga 6 meshkuj dhe 4 femra dhe mosha mesatare e tyre ka qenë 46 vjet. Ligjet kryesore që përcaktojnë detyrat e tyre janë përmendur të jenë Kodi Penal, Ligji për Policinë, Ligji për Familjen, E Drejta Civile, Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji për Mbrojtje nga DHF janë përmendur nga Mbrojtësit nga DHF dhe një punonjës nga Qendra për Punë Sociale. Kjo thekson nevojën për ndërtimin e kapaciteteve pasi që **Ligji për Mbrojtje nga DHF është gjithashtu shumë i rëndësishëm për zyrtarët e policisë dhe të gjithë punonjësit social.**

6.

Gjetjet nga sondazhi

Siç u theksua në Kapitullin 1, qëllimi ka qenë të zhvillohet një sondazh me disa institucione dhe pozita, duke përfshirë: Qendrat për Punë Sociale, Departamenti i Arsimit dhe Shëndetësisë në komuna, Zyrtarët për Barazi Gjinore, shtëpitë e sigurta, zyrtarët e policisë që punojnë në rastet e DHF, mbrojtësit ndaj DHF dhe një gjykatës. Jepni specifikat e organizimit të

6.1 Sfidat me të cilat përballen të mbijetuarit e DHF dhe si mund të trajtohen ato

Gjetjet mbi sfidat me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DHF kanë qenë pothuajse të njëjta me ato të identifikuar gjatë intervistave dhe takimit teknik të mbajtur në Mitrovicën e Veriut. Sfidat e përmendura më së shpeshti kanë të bëjnë

me mungesën e pavarësisë ekonomike të mbijetuarve të DHF, mungesën e një shtëpie të sigurtë dhe të strehimit social, frikën nga raportimi i rasteve të DHF, mungesën e sigurisë dhe mundësitë e kufizuara për punësim. Sipas të anketuarve këto sfida mund të përmirësohen nëpërmjet koordinimit më të mirë ndërmjet institucioneve, ndërtimin e një shtëpie të sigurt, ngritjen e vetëdijësimit të grave mbi të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion, ofrimin e shërbimeve adekuate dhe masat e shtuara të sigurisë për të mbijetuarit e DHF.

Në pyetjen se çfarë duhet të ndërmarrin komunitat për të siguruar që të mbijetuarit e

DHF të marrin shërbime më të përshtatshme në nivel vendor, të gjithë të anketuarit theksuan se ekziston nevoja për të mbështetur punësimin e të mbijetuarve të DHF. E një rëndësie të veçantë janë vërejtur të jenë të mëposhtmet: komunitat duhet të shtojnë një linjë të veçantë buxhetore për DHF; ekziston nevoja për të siguruar implementimin e plotë të Strategjisë për Mbrojtje Kundër DHF; forcimi i rolit të OJQ-ve dhe ofrimi i programeve trajnuese mbi DHF (Tabela 1). Shtatë nga 10 të intervistuarit deklaruan se Komunitat duhet të mbështesë financiarisht shtëpinë e sigurt.

Tabela 1: Masat e nevojshme për mbështetjen e të mbijetuarve të DHF

	Numri i të anketuarve
Të shtohet një linjë buxhetore për komunitat për DHF	9
Mbështetje financiare për shtëpinë e sigurt	7
Të sigurohet implementimi i plotë i strategjisë për Mbrojtje Kundër DHF	9
Monitorimi i implementimit të Ligjit për Mbrojtje kundër DHF	8
Të forcohet roli i OJQ-ve që punojnë në fushën e	9
Mbështetja e re-integrimit të mbijetuarve të dhunës në familje përmes pjesëmarrjes në programet e trajnimit	9
Mbështetja e punësimit të tyre	10

6.2 Koordinimi mes institucioneve në lidhje me të mbijetuarit e dhunës në familje

Si pjesë e institucioneve të angazhuara në mbrojtjen dhe mbështetjen, të anketuarit u pyetën nëse ata u takuan gjatë vitit të kaluar dhe të gjithë, përveç njërit janë përgjigjur pozitivisht. Në përgjithësi të anketuarit e vlerësojnë bashkëpunimin si të mirë (Tabela 2). Vetëm një i anketuar deklaroi se nuk ka bashkëpunim mes institucioneve, 2 deklaruan se bashkëpunimi është i dobët dhe të tjerët u

përgjigjën se bashkëpunimi mes institucioneve është i mirë, por asnjë nuk e vlerësoi si shumë të mirë.

Katër nga dhjetë të anketuar kanë deklaruar se ekziston një mekanizëm koordinues, duke iu referuar task forcës të themeluar nga OJQ AKTIV si pjesë e projektit për ndërtimin e shtëpisë të sigurt. Një memorandum i mirëkuptimit është nënshkruar në mes të gjitha institucioneve relevante. Qëllimi kryesor i kësaj task force është mbështetja e të mbijetuarve të DHF. Ata që u përgjigjën se nuk ka mekanizëm koordinues kanë deklaruar se mungesa e një mekanizmi të tillë është duke ndikuar negativisht në mbështetjen e dhënë për të mbijetuarit e DHF. Gati të gjithë të anketuarit konsiderojnë se

ekziston nevoja për të krijuar një mekanizëm koordinues për të gjitha institucionet e angazhuara për mbështetjen e të mbijetuarve të DHF. Sipas të anketuarve një mekanizëm koordinues do të përmirësonte bashkëpunimin në mes të institucioneve, do të lehtësonte efikasitetin e menaxhimit të çështjeve, rritje e identifikimit të rasteve të DHF, rritje e sigurisë për të mbijetuarit e DHF, ngritje e vetëdijësimit mbi të drejtat dhe mbështetjes e disponueshme për mbijetuarit e DHF dhe gjithashtu do të kontribuonte në imazhin e përmirësuar të institucioneve të angazhuara. Një i anketuar ka deklaruar se grupi koordinues tashmë ekziston dhe nuk ekziston nevoja për të krijuar një tjetër.

Tabela 2: Bashkëpunimi midis institucioneve

	Numri I të anketuarve
Nuk ka bashkëpunim	1
Bashkëpunim I dobët	2
Bashkëpunim I mirë	7
Bashkëpunim shumë I mirë	Asnjë

6.3 Kontributi nga komunat dhe njohuri mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor

Në pyetjen nëse komuna ku institucionet e të anketuarve veprojnë e alokojnë buxhetin për të mbështetur të mbijetuarit e DHF, 3 të anketuar kanë deklaruar se komuna e bë alokimin e buxhetit për të mbijetuarit e DHF, 4 janë përgjigjur se nuk ka buxhet të

alokuar dhe një i anketuar nuk kishte informacion. Asnjë nga tre të anketuar që deklaruan se komuna e bë alokimin e buxhetit nuk ishin të informuar mbi shumën e caktuar.

Nevojat e të mbijetuarve të DHF janë prioritet për të gjitha institucionet, përveç gjykatës. Intervistat individuale me të mbijetuarit e DHF janë burimi më i përdorur i informacionit në identifikimin e nevojave të mbijetuarve të DHF.

Për të anketuarit, buxheti i përgjegjshëm gjinor nënkupton një buxhet të veçantë për mbijetuarat femra të DHF, fonde të veçanta / buxhet për mbështetjen e arsimit, shëndetësisë dhe punësimit të grave, një buxhet për barazinë gjinore dhe një person e kupton atë si një trajtim të barabartë për të dyja gjinitë. Rezultatet tregojnë se pothuajse të gjithë të anketuarit deklaruan se institucionet e tyre nuk aplikojnë qasjen e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Arsyeja kryesore për mos aplikimin e kësaj qasje ka qenë ekziston buxheti i limituar në dispozicion, ka mungesë të informatave për nevojat e të mbijetuarve të DHF dhe nuk ka buxhet për barazi gjinore. Këto përgjigje përsëri konfirmojnë mungesën e njohurive për konceptin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor prandaj është sugjeruar nevoja për trajnime të zhvillimit të kapaciteteve në këtë fushë.

6.4 Njohuri mbi ligjet dhe strategjitë

Në pyetjen mbi ligjet dhe strategjitë që promovojnë barazinë gjinore, të anketuarit përmendën Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, ligjin për familje, ligjin dhe konventat ndërkombëtare. Dy të anketuar kanë deklaruar se nuk janë të informuar për ligjet. Dy të anketuar kanë deklaruar se nuk kanë njohuri për Ligjin për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje.

Vetëm një nga të anketuarit nuk është trajnuar mbi standardet / rregulloret bazë të punës që lidhen me rastet e dhunës në familje. Ata që kanë marrë pjesë në trajnime I kanë marrë këto trajnime nga

OSBE-ja, USAID-i, Policia e Kosovës, Akademia e Gjykatës dhe EULEX-it.

7. Përfundime dhe rekomandime

Gjetjet kryesore që rrjedhin nga ky hulumtim janë paraqitur në vijim:

- Edhe pse nuk ka të dhëna është deklaruar se dhuna në familje në baza gjinore është shumë e pranishme në veri të Kosovës;
- Mungesa e bashkëpunimit në mes të institucioneve të angazhuara në mbrojtjen dhe mbështetjen e të mbijetuarve të DHF;
- Që nga viti 2014, ekziston një task forcë e përbërë nga institucionet kryesore që janë të angazhuara në mbrojtjen dhe mbështetjen e të mbijetuarve të DHF. Megjithatë, task forca është ngritur si pjesë e një projekti të implemtuar nga një OJQ, kështu që qëndrueshmëria e task forcës sfidohet me përfundimin e projektit;
- Nuk ka buxhet të veçantë të alokuar nga komuna për mbijetuarit e DHF;
- Mungesa e shërbimeve në veçanti mungesa e programeve të rehabilitimit psiko-social-ekonomik për gratë;
- Burimet e kufizuara financiare në nivel komunal për mbështetjen e të mbijetuarve të DHF;

- Ekiston vetëdijësim i dobët në mesin e grave mbi të drejtat e tyre dhe mbështetjen e disponueshme;
- Për shkak të mungesës së besimit në sistemin e drejtësisë (implemetim i dobët i urdhrave të mbrojtjes, sanksione të lehta, vetëdijësim i dobët mbi pasojat për ata që ushtrojnë dhunë) ekziston raportim i ulët i rasteve të DHF;
- Prania e stigmatizimit nga shoqëria, ku dhuna në familje është ende një tabu, që parandalon gratë të kërkojnë ndihmë;
- Mungesa e një shtëpie të sigurt është një sfidë kryesore me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DHF;
- Varësia ekonomike e të mbijetuarve të DHF pretendohet të jetë arsyeja kryesore për raportim të ulët dhe gjithashtu për kthimin e grave të DHF tek burimi i dhunës (kryesisht tek burrat e tyre);
- Mos-ekzistenca e shërbimeve për të punuar me kryerësit e DHF;
- Njohuri të kufizuara mbi ligjet, strategjitë dhe PSO-të ndërkombëtare dhe kombëtare; dhe
- Institucionet nuk aplikojnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe për më tepër ka mungesë të njohurive mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Duke u mbështetur në gjetjet nga ky hulumtim, janë paraqitur rekomandimet kryesore:

- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përmes krijimit të një mekanizmi të qëndrueshëm që do të udhëhiqet nga komuna dhe koordinohet nga një

koordinator lokal në nivel komunal. Ky mekanizëm do të lehtësojë raportimin e rregullt, të përmirësojë shërbimet për të mbijetuarit e DHF, të kontribuojë në menaxhimin efikas të rastit dhe të kontribuojë në mbrojtjen nga DHF;

- Lobimi me komunat për alokimin e një buxheti të veçantë për shërbimet për DHF;
- Organizimi e aktiviteteve që do të ngritin vetëdijësimin mes grave që janë subjekt i DHF mbi të drejtat e tyre dhe shërbimet e disponueshme, të autorëve mbi pasojat me të cilat ata do të ballafaqohen dhe për ngritjen e vetëdijësimin në komunitetin e gjerë duke kontribuar në uljen e rasteve të DHF;
- Ndërtimi i shtëpisë të sigurt e cila gjithashtu do të ofrojë këshillim dhe shërbime psiko-sociale për të mbijetuarit e DHF;
- Projekte për mbështetjen e riaftësisimit të mbijetuarve të DHF dhe të punësimit të tyre;
- Ofrimi i këshillimit dhe rehabilitimit për kryerësit e DHF;
- Organizimi i trajnimeve mbi ligjet, strategjitë, PSO-të;
- Ofrimi i trajnimeve mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor;
- Të rritet roli i OJQ-ve në fushën e DHF;
- Të sigurohet implementimi i plotë dhe monitorimi i

strategjisë për Mbrojtjen
Kundër DHF;

- Zhvillimi i strategjive në baza lokale për të mbështetur të mbijetuarit e DHF.

Referencat

Waugh, C., 2013, Raport mbi dhunën në familje në Veri të Kosovës: Gjendja Institucionale dhe Rajon, OJQ Aktiv.

Shtojca 1: Pyetësi

UNWOMEN

2015

Pyetësor lidhur me mbrojtjen dhe mbështetjen e dhënë për të mbijetuarit e dhunës në familje

Qëllimi i këtij pyetësi është mbledhja e informacionit për mbrojtjen dhe mbështetjen e dhënë për të mbijetuarit e dhunës në familje. Studimi gjithashtu ka për qëllim të identifikojë nevojën për mekanizmin koordinues I cili është vërtetuar se lehtëson në masë të madhe mbrojtjen dhe mbështetjen për të mbijetuarit e dhunës në familje në disa pilot komuna. Në fund, studimi synon të identifikojë nevojat e zhvillimit të institucioneve që mbrojnë dhe mbështesin të mbijetuarit e dhunës në familje të cilat do të shërbejnë si bazë për të hartuar trajnime dhe aktivitete të tjera që synojnë përmirësimin e shërbimeve të ofruara për të mbijetuarit e dhunës në familje.

Pyetësi është anonim dhe intervista do të realizohet nga studiues të angazhuar për realizimin e intervistave.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

1. Institucioni:

1.1. Komuna:

2. Pozita:

3. Gjinia: 1. Femër

2. Mashkull

4. Mosha:

5. Ju lutem tregoni Ligjin dhe rregulloret që përcaktojnë detyrat tuaja.

1.

2.

3.

4.

X. Problemet me të cilat ballafaqohen të mbijetuarit e DHF dhe propozimet

6. Çfarë mendoni se janë tre çështjet/problemet më të mëdha e mbijetuarve të DHF lidhur me fushën tuaj të punës?

1.

2.

3.

7. Nëse ka çështje që duhet të trajtohen ju lutem tregoni tre mënyrat kryesore se si mund të zgjidhen këto sfida?

1.

2.

3.

7.1 A ekziston ndonjë shtëpi strehuese në komunën tuaj?

1.Po 2. Jo

7.2 Nëse nuk ekziston një shtëpi strehuese, a mendoni se ekziston nevoja për një shtëpi strehuese?

1. Po 2. Jo

8. Çfarë mendoni se qeveria lokale / komuna duhet të bëjë për të siguruar që të mbijetuarit e DHF të marrin shërbime më adekuate në nivel lokal?

4. Të shtohet një linjë buxhetore për komunat për DHF
5. Mbështetja financiare e një shtëpi strehuese
6. Të sigurohet implementimi i plotë i strategjisë për Mbrojtje Kundër DHF
7. Monitorimi i Ligjit për Mbrojtje Kundër DHF
8. Rritja e rolit të OJQ-ve që punojnë në fushën e DHF
9. Mbështetja e re-integrimit të mbijetuarve të dhunës në familje përmes pjesëmarrjes në programet e trajnimit
10. Mbështetja e punësimit të tyre
11. Të tjera (ju lutemi specifikoni)

XI. Koordinimi mes institucioneve të përfshira në lidhje me të Mbijetuarit e Dhunës në Familje

9. Ekzistojnë disa institucione të angazhuara në mbrojtjen dhe mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës në familje. A jeni takuar ndonjëherë me këto institucione gjatë vitit 2014?

1. Po 2. Jo

10. Si do ta vlerësonit bashkëpunimin në mes të këtyre institucioneve?

1. Nuk ka bashkëpunim
2. Bashkëpunim I dobët
3. Bashkëpunim I mirë
4. Bashkëpunim shumë I mirë

11. A ekziston ndonjë mekanizëm që I bashkon të gjitha institucionet:

1. Po 2. Jo

11a. Nëse ekziston një mekanizëm koordinues, atëherë ju lutem shpjegoni shkurtimisht duke theksuar rolin e mekanizmit.

11b. Nëse nuk ekziston një mekanizëm koordinues, si ndikon mungesa e tij në

mbështetjen për mbijetuarit e DHF?

1. Nuk ka ndikim
2. Ka ndikim negativ
3. Të tjera _____

12. A mendoni se ekziston nevoja për një mekanizëm koordinues i cili do të përfshinte të gjitha institucionet relevante që ofrojnë mbështetje për të mbijetuarit e DHF?

1. Po
2. Jo

13. Nëse Po: Ju lutem emëroni tre përfitimet kryesore që do të rezultojnë nga mekanizma të tillë koordinues

- 1.
- 2.
- 3.

14. Nëse mendoni se nuk ekziston nevoja për mekanizma koordinues, ju lutem shpjegoni pse mendoni se nuk ekziston një nevojë e tillë.

XII. Niveli I njohurive mbi BPGJ

15. Komuna në të cilën ju veproni, a e bën ndarjen e buxhetit për mbështetje për të mbijetuarit e DhF?

4. Po
2. Jo
3. Nuk e di

15.1 Nëse Po, a keni njohuri se cila është % e këtij buxheti në buxhetin total të Komunës për një vit? _____%

16. A I jep prioritet institucioni juaj nevojave të mbijetuarve të DhF?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di

16.1 Në Po, si I identifikoni nevojat e të mbijetuarve të DHF?

5. Përmes intervistave individuale me të mbijetuarit e DHF
6. Grupet e fokusit me të mbijetuarit e DHF

7. Takimet në komunitet
8. Të tjera? (ju lutem specifikoni)

Buxheti gjinor

17. Si e kuptoni Buxhetimin Gjinor?

18. A përdorni Buxhetimin Gjinor si një mjet planifikimi në institucionin tuaj?

1. Po; 2. Jo; 3. Nuk e di

18.1 Nëse PO, ju lutem përshkruani si e përdorni atë (për çfarë qëllimesh dhe kur saktësisht)?

18.2 Nëse JO, pse mendoni se institucioni juaj nuk përdor BPGJ?

XIII. Niveli I njohurive mbi Ligjet dhe dokumentet ndërkombëtare me rëndësi për barazinë gjinore.

19. A mund të emëroni ligjet, strategjitë dhe planet që mbështesin / promovojnë barazinë gjinore në komunën tuaj.

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.

20. A keni njohuri mbi Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje?

3. Po 2. Jo

21. A mund të emëroni dokumentet ndërkombëtare lidhur me barazinë gjinore me fokus në dhunën në familje.

- 1.
- 2.
- 3.

22. A keni marrë ndonjëherë trajnim në punë në lidhje me standardet / rregulloret themelore të punës lidhur me rastet e dhunës në familje?

1. Po 2. Jo

22.1 Nëse Po, cilat institucione / organizata kanë ofruar trajnime dhe kur?

Institucioni	Viti

XIV. Komentet dhe propozimet

23. Ju lutem shtoni komente dhe propozime

Data e intervistimit:

Shtojca 2: Lista e personave të intervistuar

Nr.	Emri	Institucioni	Pozita	Komuna
1	Natasa Marovic	QPS	Përfaqësuese e ekipit për DHF	Mitrovica veriore dhe Zveçani
2	Dusica Djinovic	QPS	Zëvendës Drejtoreshë	Mitrovica veriore dhe Zveçani
3	Jelena Radosavljević	QPS	Pedagoge e specializuar	Zubin Potok
4	Mila Milojević-	QPS	Punonjëse sociale	Leposavic
5	Danijela Nikolić	QPS	Punonjëse sociale	Leposavic
6	Milosav Gvozdović	Komuna	Shef i financave	Zveçan
7	Zoran Bratić	Komuna	Shef i financave	Mitrovica veriore
8	Ljiljana Lakusic	Komuna	Shefe e financave	Leposavic
9	Srđan Vučinić	Komuna	Shef I financave	Zubin Potok
10	Bojana Bojovic	OJQ "Zensko Pravo"	Drejtoresha e financave	Mitrovica veriore
11	Caleb Waugh	OJQ "Aktiv"	Koordinator I programit	Mitrovica veriore

